

VENDIM

Nr.750, datë 14.7.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË INSPEKTIMIT KARANTINOR FITOSANITAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20 të ligjit nr.9362, datë 24.3.2005 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të parandalojë hyrjen dhe përhapjen e parazitëve karantinorë në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të siguruar një mbrojtje sa më të mirë të bimëve e të produkteve bimore.
2. Objekti i këtij vendimi është të sigurojë kushtet teknike dhe ligjore në punën e inspektorëve, në zbatim të ligjit nr.9362, datë 24.3.2005 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", të ndryshuar.

II. PËRKUFIZIME

Në kuptim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Ngarkesë", një sasi bimësh, produktesh bimore dhe/ose objektesh të tjera, të parashikuara në këtë vendim, të cilat lëvizin nga një shtet në tjetrin dhe që përfaqësohen nga një certifikatë fitosanitare e vetme (një ngarkesë mund të jetë e përbërë nga një ose më shumë lote).
2. "Pikë doganore hyrjeje", aeroporti, porti detar ose një pikë hyrjeje kufitare tokësore, të përcaktuara zyrtarisht për hyrjen e bimëve, të produkteve bimore ose të objekteve të tjera, të parashikuara në këtë vendim.
3. "Provë", ekzaminimi zyrtar, i ndryshëm nga ai pamor, për të përcaktuar një parazit ose për të vërtetuar praninë e tij në një ngarkesë.
4. "Rieksport" (ngarkesë e rieksportuar), një ngarkesë, e cila është importuar në një shtet, nga i cili pastaj eksportohet pa u ekspozuar ndaj infektiveve ose kontaminimeve nga parazitët edhe nëse ngarkesa ruhet, ndahet, kombinohet me ngarkesa të tjera ose i ndryshohet ambalazhi.
5. "Trajtim", një procedurë zyrtare e autorizuar për ngordhjen, largimin ose bërjen jopjellore të parazitëve.
6. "Vend origjine", për bimët, vendi ku bimët janë kultivuar; për produkte bimore, vendi ku janë kultivuar bimët, prej të cilave janë përfutur produktet bimore; dhe për objekte të tjera, vendi ku këto objekte janë ekspozuar për herë të parë ndaj parazitëve dhe mund të jenë infektuar ose kontaminuar prej tyre.
7. "Zonë e paprekur", një zonë e pastër e përcaktuar nga ministri që mbulon fushën e bujqësisë, si zonë për të realizuar dhe për të siguruar pastërti fitosanitare në një ose më

shumë kultura bujqësore të caktuara ndaj një ose disa parazitëve karantinorë përkatës.

III. KONTROLI KARANTINOR

1. Ndalohet hyrja dhe përhapja në territorin e Republikës së Shqipërisë:

a) e parazitëve të përmendur në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi;
b) e bimëve dhe e produkteve bimore, të përmendura në aneksin II, bashkëlidhur këtij vendimi, kur pas inspektimit fitosanitar ato rezultojnë të infektuara apo të kontaminuara nga parazitë të specifikuar në këtë aneks.

2. Ndalohet importimi në Republikën e Shqipërisë i bimëve apo i produkteve bimore, të përmendura në aneksin III, bashkëlidhur këtij vendimi, kur ato kanë origjinë prej shteteve të përmendura në këtë aneks.

3. Këshilli i Ministrave ka të drejtë të ndalojë hyrjen dhe përhapjen në territorin e Republikës së Shqipërisë:

a) të parazitëve, të cilët nuk janë përmendur në anekset I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi;
b) të parazitëve të përmendur në aneksin II, por të ndodhur në bimë e produkte bimore të papërmendura në këtë aneks.

4. Hyrja dhe transferimi në territorin e vendit të parazitëve të përmendur në anekset I dhe II, si dhe i bimëve, produkteve bimore e objekteve të tjera, të përmendura në aneksin III, të nevojshme për qëllime studimore-shkencore, punë seleksionuese dhe të rezistencës varjetore, janë të mundshme vetëm në bazë të një autorizimi të veçantë, lëshuar nga ministri që mbulon fushën e bujqësisë. Autorizuesi duhet të sigurohet zyrtarisht për garantimin e masave të karantinës dhe kushtet e mbrojtjes nga rreziku fitosanitar. Zbatimi i këtyre kufizimeve duhet të kërkohet para importimit. Materiali i importuar pa respektuar këto kushte duhet të rieksportohet ose të shkatërrohet dhe për këtë duhet të njoftohen autoritetet e mbrojtjes së bimëve.

5. Hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë e bimëve, produkteve bimore apo e objekteve të tjera, të përcaktuara në aneksin IV, bashkëlidhur këtij vendimi, seksioni 1, është e lejuar vetëm pasi ato i janë nënshtruar inspektimit fitosanitar dhe kur janë plotësuar kërkesat e veçanta, të përcaktuara në këtë seksion.

6. Sasi të vogla bimësh e produktesh bimore, të cilat parashikohen të përdoren nga zotëruesi ose pritësi i tyre për përdorim vetjak dhe jo për qëllime tregtare ose industriale, i nënshtrohen inspektimit fitosanitar, kur inspektori e gjykon të arsyeshme. Ato nuk lejohen të hyjnë kur përbëjnë objekte që përmenden në aneksin III dhe ndalohen apo kufizohen kur gjenden të infektuara a kontaminuara me parazitë, të përmendur në anekset I, II dhe III, bashkëlidhur këtij vendimi.

7. Hyrja në territorin e Republikës së Shqipërisë e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, të përcaktuara në aneksin V, pjesa B, bashkëlidhur këtij vendimi, ose të papërcaktuara në aneksin V, pjesa B, por të pajisur me certifikatë fitosanitare, lejohet vetëm nëse ato, ambalazhet dhe mjetet e transportit të tyre janë inspektuar zyrtarisht, në tërësi ose nëpërmjet mostrës përfaqësuese, dhe nga inspektimi ka rezultuar se:

a) bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera, të përcaktuara në aneksin V, pjesa B, nuk janë të infektuara apo të kontaminuara nga parazitët e përcaktuar në aneksin I;

b) bimët ose produktet bimore, të përcaktuara në aneksin II, nuk janë të infektuara apo të kontaminuara nga parazitë të përmendur në këtë aneks;

c) bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera, të përcaktuara në aneksin IV, seksioni 1, plotësojnë kërkesat e veçanta të parashikuara në këtë aneks.

Në rastet kur inspektori gjykon se duhet të merret mostër përfaqësimi e ngarkesës së bimëve, produkteve bimore ose objekteve të tjera, të përcaktuara në aneksin V, pjesa B, me qëllim përcaktimin laboratorik të gjendjes fitosanitare, mostra dërgohet për analiza në laboratorin e mbrojtjes së bimëve. Shpenzimet e analizave i ngarkohen zotëruesit të ngarkesës.

8. Kur bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera, të përcaktuara në aneksin V, pjesa B, importohen, duhet të jenë të shoqëruara me certifikatë fitosanitare të lëshuar prej autoritetit zyrtar fitosanitar të vendit të origjinës, si më poshtë vijon:

a) Në rastet kur për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera ka kërkesa të veçanta të përcaktuara në aneksin IV, seksioni 1, certifikatë fitosanitare duhet të jetë e lëshuar nga autoriteti zyrtar fitosanitar i vendit të origjinës, me përjashtim të:

i) drurit, i cili mund shoqërohet me certifikatë fitosanitare, të lëshuar nga autoriteti zyrtar fitosanitar i ndryshëm nga vendi i origjinës, në qoftë se, sipas kërkesave të veçanta të parashikuara në aneksin IV, seksioni 1, druri është përpunuar (zhveshur lëvorja) në këtë vend;

ii) rasteve të tjera të veçanta, të parashikuara në aneksin IV, seksioni 1, kur ngarkesa shoqërohet me certifikatë fitosanitare, të lëshuar nga autoriteti zyrtar fitosanitar i ndryshëm nga vendi i origjinës.

b) Në qoftë se pjesë nga një ngarkesë bimësh a produktesh bimore është ndarë apo është vënë në magazinim ose asaj ngarkese i është ndërruar ambalazhimi në një vend të ndryshëm nga vendi i origjinës, ajo duhet të shoqërohet me një certifikatë fitosanitare, e lëshuar nga autoriteti zyrtar fitosanitar i vendit rieksportues ose me një certifikatë fitosanitare rieksporti, së bashku me certifikatë fitosanitare, të lëshuar nga autoriteti zyrtar i vendit të origjinës.

c) Certifikatë fitosanitare ose certifikatë fitosanitare e rieksportit duhet të përmbajnë informacionin, sipas modelit të Konventës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Bimëve, dhe duhet të jenë lëshuar nga autoriteti zyrtar i vendit eksportues/rieksportues. Certifikata duhet të jetë modeluar në të paktën njërën prej gjuhëve zyrtare të Komunitetit European. Emri botanik i bimës/bimëve duhet të jetë në gjuhën latine.

ç) Korrigjimet apo ndryshimet e bëjnë të pavlefshme një certifikatë fitosanitare. Origjinali dhe kopja e një certifikatë fitosanitare dallohen nga fjalët "Original" ose "Copy" (Duplicate), të stampuara në të.

d) Certifikatë fitosanitare ose certifikatë fitosanitare e rieksportit duhet të jenë lëshuar nga autoriteti fitosanitar zyrtar i vendit të origjinës apo i vendit rieksportues jo më parë se 14 (katërmëdhjetë) ditë nga çasti kur bimët, produktet bimore apo objektet e tjera i nënshtrohen inspektimit fitosanitar në pikat doganore të daljes. Zgjatja e këtij afati bëhet duke llogaritur kohën në rastet kur ngarkesat me bimë, produkte bimore ose objekte të tjera transportohen me rrugë detare nga vende të largëta të origjinës. Gjithsesi, ndërmjet datës së nxjerrjes së certifikatës fitosanitare të vendit të origjinës dhe datës së ngarkimit, nuk duhet të kalojnë më

shumë se 14 (katërbëdhjetë) ditë.

9. Kushtet e parashikuara në pikat 2 e 7 të këtij kreu, nuk zbatohen për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera që kalojnë tranzit në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat i nënshtrohen inspektimit fitosanitar, gjatë të cilit rezulton se ambalazhimi i tyre është bërë në kushte të tilla sigurie që garanton mospërhapjen e parazitëve karantinorë.

10. Ministri, nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe, mund të kërkojë që inspektimet fitosanitare, të cilat lidhen me pikën 7, të kryhen në shtetin eksportues, në bashkëpunim me autoritetet fitosanitare të këtij shteti.

11. Në rast se bimë apo produkte bimore janë të destinuara për një zonë të paprekur, kushtet e përcaktuara në pikën 7, do të zbatohen në përputhje me kërkesat e veçanta në fuqi për këtë zonë.

12. Importuesit e bimëve, të produkteve bimore apo të objekteve të tjera, të parashikuara në këtë vendim, duhet të regjistrohen sipas kreut V të këtij vendimi.

13. Importuesit e bimëve, të produkteve bimore apo të objekteve të tjera, të parashikuara në këtë vendim, janë të detyruar të informojnë 48 (dyzet e tetë) orë para mbërritjes së ngarkesës në pikën kufitare të hyrjes, drejtorinë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit (DRBUMK), përgjegjëse për atë pikë kufitare, për vendin e origjinës, llojin, qëllimin e importimit, destinacionin dhe specifikime të tjera që mund t'i kërkojnë rreth ngarkesës që pritet të arrijë.

14. Kur pas inspektimit fitosanitar rezulton se kushtet e përcaktuara në pikën 7 të këtij kreu, nuk plotësohen, atëherë, sipas rastit, merren këto masa:

- a) Bërja e trajtimit fitosanitar me metoda, të cilat garantojnë dezinfektimin e ngarkesës;
- b) Ndarja e pjesëve të infektuara apo të kontaminuara të ngarkesës dhe asgjësimi i tyre me metoda, të cilat garantojnë shkatërrimin e plotë të parazitit e mundësisë së përhapjes së tij në territorin e vendit;
- c) Vendosja e mallit në regjim karantinor deri sa të dalin rezultatet zyrtare të analizave;
- ç) Lejimi i transportit nën kontrollin e inspektorëve në vendin e përpunimit industrial, kur përpunimi garanton shkatërrimin e plotë të parazitit dhe të mundësisë së përhapjes së tij në territorin e vendit;
- d) Kthimi mbrapsht i ngarkesës;
- dh) Asgjësimi i ngarkesës me metoda të cilat garantojnë shkatërrimin e plotë të parazitit e të mundësisë së përhapjes së tij në territorin e vendit.

15. Të gjitha shpenzimet, që lidhen me masat e përmendura në pikën 14 të këtij kreu përballohen nga zotëruesi i ngarkesës.

16. Në rastet kur importuesi refuzon ndërmarrjen e masave të parashikuara në pikën 14 të këtij kreu, inspektori vendos në certifikatën fitosanitare vulën e shërbimit të mbrojtjes së bimëve dhe me ngjyrë të kuqe vulën me mbishkrimin "certifikate cancelled", me emrin e inspektorit, si dhe datën e refuzimit.

17. Kur inspektimi fitosanitar sipas pikës 7 është përfunduar, inspektori fitosanitar i pikës kufitare të hyrjes harton një raport, sipas modelit të paraqitur në aneksin XI, bashkëlidhur këtij vendimi, për rezultatin e inspektimit fitosanitar të ngarkesës, raport, i cili i bashkëlidhet

dokumenteve të tjera, të cilat së bashku, paraqiten në zyrën e autoritetit doganor për kryerjen e veprimeve përkatëse.

18. Bimët, produktet bimore dhe objekte të tjera, të parashikuara në këtë vendim, për të cilat shteti importues parashikon kërkesa të veçanta, duhet të jenë të shoqëruara me dokumentet e mëposhtme:

a) certifikatë fitosanitare, për ngarkesat me origjinë nga Shqipëria;

b) certifikatë fitosanitare rieksperti dhe certifikatë fitosanitare të vendit të origjinës, për ngarkesat jo me origjinë nga Shqipëria kur malli është ndarë në disa destinacione, është magazinuar ose është riambalazhuar.

19. Certifikatë fitosanitare dhe certifikatë fitosanitare rieksperti lëshohen pas inspektimit, kur gjykohet nga inspektori se ngarkesa i plotëson të gjitha kërkesat e veçanta të përcaktuara nga shteti importues.

20. Eksportuesit e bimëve, të produkteve bimore apo të objekteve të tjera të parashikuara në këtë vendim, janë të detyruar të njoftojnë 48 (dyzet e tetë) orë para nisjes së ngarkesës për eksport, strukturat e mbrojtjes së bimëve pranë DRBUMK-së, përgjegjëse për territorin nga është origjina e ngarkesës, për përmbajtjen, prodhuesin, destinacionin dhe specifikime të tjera që mund t'u kërkojnë për kryerjen e inspektimit fitosanitar dhe pajisjen me certifikatë fitosanitare të ngarkesës që do të eksportohet.

21. Kushtet e parashikuara në shkronjat "c" dhe "d" të pikës 8, janë të vlefshme edhe për certifikatë fitosanitare të eksportit dhe rieksporit, modeli i të cilave jepet në anekset VII e VIII, bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. MASAT FITOSANITARE PËR LËVIZJEN E BIMËVE E TË PRODUKTEVE BIMORE TË PRODHUARA NË SHQIPËRI, SI DHE TË OBJEKTEVE TË TJERA, TË CILAT TRAJTOHEN NË KËTË VENDIM

1. Lëvizja brenda territorit të Republikës së Shqipërisë e bimëve, produkteve bimore dhe e objekteve të tjera, të prodhuara në vend, të përmendura në aneksin V, pjesa A, bashkëlidhur këtij vendimi, lejohet vetëm nëse ato, ambalazhet e tyre dhe, nëse është e nevojshme, edhe mjeti i transportit, i janë nënshtruar inspektimit fitosanitar.

2. Inspektimi fitosanitar i përmendur në pikën 1 të këtij kreu, kryhet nga inspektorët e mbrojtjes së bimëve të rrethit nga kanë origjinën bimët dhe produktet bimore. Inspektimi mund të kryhet me vrojtim të përgjithshëm apo me marrje mostre.

Në varësi të objektit që inspektohet, ekzaminimet e nevojshme mund të kryhen edhe gjatë vegetacionit në parcelën e kultivimit apo gjatë magazinimit.

3. Bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera të parashikuara në këtë vendim, të prodhuara në vend dhe të përmendura në aneksin V, pjesa A, pajisen me certifikatë fitosanitare të brendshme, sipas aneksit IX, bashkëlidhur këtij vendimi, nëse pas inspektimit të kryer sipas pikës 1 të këtij kreu, rezultojnë se:

a) janë të painfektuara ose të pakontaminuara me parazitë të përmendur në aneksin I, seksioni 2.

b) janë të painfektuara ose të pakontaminuara me parazitë të përmendur në aneksin II, seksioni 2.

c) plotësojnë kushtet e veçanta që kërkohen në aneksin IV, seksioni 2.

4. Kur pas inspektimit fitosanitar të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera të parashikuara në këtë vendim rezulton se kushtet e përcaktuara në pikën 3 të këtij kreu, nuk plotësohen, atëherë, sipas rastit, merren këto masa:

a) bërja e trajtimit fitosanitar me metoda, të cilat garantojnë dezinfektimin e tyre dhe pajisja me certifikatë fitosanitare të brendshme;

b) largimi i pjesëve të infektuara dhe bërja e asgjësimit të tyre me metoda, të cilat garantojnë shkatërrimin e plotë të parazitëve dhe bëjnë të pamundur përhapjen e tyre në territorin e vendit dhe, më pas, pajisja me certifikatë fitosanitare të brendshme;

c) lejimi i transportimit, nën kontrollin e inspektorëve, në zona që nuk paraqesin rrezik të mëtejshëm ose në vende ku do të bëhet përpunimi industrial, kur ky përpunim garanton shkatërrimin e plotë të parazitëve dhe bën të pamundur përhapjen e tyre në territorin e vendit;

ç) asgjësimi i plotë me metoda, të cilat garantojnë shkatërrimin e plotë të parazitëve dhe bëjnë të pamundur përhapjen e tyre në territorin e vendit.

Të gjitha shpenzimet, që lidhen me masat e përmendura në shkronjat "a" - "ç" të kësaj pike, bëhen me shpenzimet e zotëruesit të ngarkesës.

5. Bimët, produktet bimore ose objektet e tjera, që hyjnë në një zonë të paprekur, duhet të jenë të shoqëruara me certifikatë fitosanitare të brendshme, e cila duhet të deklarojë pastërtinë fitosanitare nga një ose disa parazitë të përmendur në këtë vendim, që infektojnë ose prekin bimët/kulturat, produktet bimore ose objektet e tjera, për të cilat ajo zonë e paprekur është vendosur/njohur si e tillë.

Rregullat për njohjen e zonave të paprekura dhe për lëvizjen e bimëve, të produkteve bimore e të objekteve të tjera brenda një zone të paprekur miratohen me akt nënligjor të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

6. Kushtet e parashikuara në pikat 1, 2, 3, e 4 të këtij kreu, nuk zbatohen në rastet e sasive të vogla të bimëve apo të produkteve bimore të përmendura në aneksin V, pjesa A, kur ato janë të destinuara për konsum vetjak, jo për qëllime tregtimi ose riprodhimi dhe kur gjykohet se ato nuk mund të jenë a nuk mund të bëhen burim i përhapjes së parazitëve të përmendur në anekset I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

7. "Certifikatë fitosanitare", "certifikatë fitosanitare e rieksporit" e "certifikatë fitosanitare e brendshme" përgatiten dhe shpërndahen nga struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve.

8. Inspektorët e mbrojtjes së bimëve, në zbatim të këtij vendimi, kanë të drejtë të kryejnë inspektime në bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera të parashikuara në këtë vendim pa asnjë dallim apo paragjykim mbi origjinën e tyre, në çdo vend ku ato mbillen, kultivohen, prodhohen, magazinohen, ofrohen për shitje e blerje.

V. REGJISTRIMI I IMPORTUESVE, EKSPORTUESVE, PRODHUESVE, QENDRAVE TË GRUMBULLIMIT DHE ATYRE TË SHITJES ME SHUMICË

1. Personat fizikë dhe juridikë, që merren me importimin, prodhimin, grumbullimin dhe shitjen me shumicë të bimëve, produkteve bimore e të objekteve të tjera që trajtohen në këtë vendim, ndaj të cilave kërkohet të kryhen inspektime fitosanitare, sipas pikës 1 të kreut III, duhet të regjistrohen në drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së

konsumatorit, sipas udhëzimit të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

2. Rregullat për regjistrimin e personave fizikë dhe juridikë, që merren me importimin, prodhimin, grumbullimin dhe shitjen me shumicë të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, miratohen me akt nënligjor të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

VI. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Në rastet e shfaqjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të parazitëve të përmendur në aneksin I, seksioni 1 ose në aneksin II, seksioni 1, struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve njofton menjëherë organizmat ndërkombëtarë dhe shtetet kufitare, duke marrë njëkohësisht të gjitha masat për ndalimin e përhapjes së mëtejshme dhe çrrënjosjen e tyre.

2. Në rastet e shfaqjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të parazitëve karantinorë të papërmendur në aneksin I, seksioni 1 ose në aneksin II, seksioni 1, struktura përgjegjëse e mbrojtjes së bimëve njofton menjëherë organizmat ndërkombëtarë dhe shtetet kufitare, duke marrë, njëkohësisht të gjitha masat për ndalimin e përhapjes së mëtejshme dhe çrrënjosjen e tyre.

3. Anekset janë pjesë përbërëse e këtij vendimi. Ndryshimet e anekseve bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit që mbulon fushën e bujqësisë.

4. Ngarkohet ministria që mbulon fushën e bujqësisë për zbatimin e këtij vendimi.

VII. SHFUQIZIME

Vendimi nr.72, datë 6.2.2003 i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të inspektimit karantinor fitosanitar", shfuqizohet.

VIII. HYRJA NË FUQI

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

ANEKSI I

PJESA A

PARAZITË, HYRJA DHE PËR HAPJA E TË CILËVE BRENDA TERRITORIT TË SHQIPËRISË ËSHTË E NDALUAR

SEKSIONI 1

PARAZITË QË NUK JANË HASUR NË TERRITORIN E SHQIPËRISË

(a) Insekte, këpusha dhe nematode në të gjitha stadet e zhvillimit të tyre

1. Acleris spp. (joeuropean)
2. Amauromyza maculosa (Malloch)
3. Anomala orientalis Waterhouse
4. Anoplophora chinensis (Thomson)

- 4.1. *Anoplophora glabripennis* (Motschulsky)
5. *Anoplophora malasiaca* (Forster)
6. *Arrhenodes minutus* Drury
7. *Bemisia tabaci* Genn., (populacione joeuropiane) vektorë të viruseve të tilla si:
 - (a) Bean golden mosaic virus
 - (b) Cowpea mild mottle virus
 - (c) Lettuce infectious yellows virus
 - (d) Pepper mild tigre virus
 - (e) Squash leaf curl virus
 - (f) Euphorbia mosaic virus
 - (g) Florida tomato virus
8. Cicadellidae (joeuropiane) të njohura si vektorë të sëmundjes Pierce's disease (shkaktuar nga *Xylella fastidiosa*), të tilla si:
 - a) *Carneocephala fulgida* Nottingham
 - b) *Draeculacephala minerva* Ball
 - c) *Graphocephala atropunctata* (Signoret)
9. *Choristoneura* spp. (joeuropiane)
10. *Conotrachelus nenuphar* (Herbst) *Diabrotica barberi* Smith & Lawrence *Diabrotica undecimpunctata howardi* Barber *Diabrotica undecimpunctata undecimpunctata* Mannerheim *Diabrotica virgifera* Le Conte
11. *Globodera pallida* (Stone) Behrens *Globodera rostochiensis* (Wollenweber) Behrens
12. *Heliothis zea* (Boddie)
 - 12.1. *Hirschmanniella* spp., përveç *Hirschmanniella gracilis* (de Man) Luc & Goodey
13. *Liriomyza sativae* Blanchard
14. *Longidorus diadecturus* Eveleigh and Allen
15. *Meloidogyne chitwoodi* Golden et al. (gjithë popullatat)
 - 15.1. *Meloidogyne fallax* Karssen
16. *Monochamus* spp. (joeuropiane)
17. *Myndus crudus* Van Duzee
18. *Nacobbus aberrans* (Thorne) Thorne et Allen
 - 18.1. *Naupactus leucoloma* Boheman
19. *Opogona sacchari* (Bojer)
20. *Popilia japonica* Newman
21. *Premnotypes* spp. (joeuropiane)
22. *Pseudopithyophthorus minutissimus* (Zimmermann)
23. *Pseudopithyophthorus pruinus* (Eichhoff)
24. *Rhizoecus hibisci* Kawai and Takagi
25. *Scaphoideus luteolus* (Van Duzee)
26. *Spodoptera eridania* (Cramer)
27. *Spodoptera frugiperda* (Smith)
28. *Spodoptera littoralis* (Boisduval)

29. *Spodoptera litura* (Fabricius)
30. *Thrips palmi* Karny
31. Tephritidae (joeuropiane), tē tilla si:
- (a) *Anastrepha fraterculus* (Wiedemann)
 - (b) *Anastrepha ludens* (Loew)
 - (c) *Anastrepha obliqua* Macquart
 - (d) *Anastrepha suspensa* (Loew)
 - (e) *Dacus ciliatus* Loew
 - (f) *Dacus cucurbitae* Coquillett
 - (g) *Dacus dorsalis* Hendel
 - (h) *Dacus tryoni* (Froggatt)
 - (i) *Dacus tsuneonis* Miyake (j) *Dacus zonatus* Saund.
 - (k) *Epochra canadensis* (Loew)
 - (l) *Pardalaspis cyanescens* Bezzi (m) *Pardalaspis quinaria* Bezzi
 - (n) *Pterandrus rosa* (Karsch)
 - (o) *Rhacochlaena japonica* Ito
 - (p) *Rhagoletis cingulata* (Loew)
 - (q) *Rhagoletis completa* Cresson
 - (r) *Rhagoletis fausta* (Osten-Sacken)
 - (s) *Rhagoletis indifferens* Curran
 - (t) *Rhagoletis mendax* Curran
 - (u) *Rhagoletis pomonella* Walsh
 - (v) *Rhagoletis ribicola* Doane
 - (w) *Rhagoletis suavis* (Loew)
32. *Xiphinema americanum* Cobb sensu lato (popullata joeuropiane)
33. *Xiphinema californicum* Lamberti et Bleve-Zacheo

(b) Baktere

1. *Clavibacter michiganensis* (Smith) Davis et al. ssp. *sepedonicus* (Spieckermann and Kotthoff) Davis et al.
2. *Pseudomonas solanacearum* (Smith) Smith
3. *Ralstonia solanacearum* (Smith) Yabuuchi et al.
4. *Xylella fastidiosa* (Wells et Raju)
5. *Xylophilus ampelinus* (Panagopoulos) Willems et al.

(c) Kērpudha

1. *Ceratocystis fagacearum* (Bretz) Hunt
2. *Chrysomyxa arctostaphyli* Dietel
3. *Cronartium* spp. (joeuropiane)
4. *Endocronartium* spp. (joeuropiane)
5. *Guignardia laricina* (Saw.) Yamamoto et Ito
6. *Gymnosporangium* spp. (joeuropiane)
7. *Inonotus weirii* (Murrill) Kotlaba et Pouzar

8. *Melampsora farlowii* (Arthur) Davis
9. *Melampsora medusae* Thumen
10. *Monilinia fructicola* (Winter) Honey
11. *Mycosphaerella larici-leptolepis* Ito et al.
12. *Mycosphaerellapopulorum* G.E. Thompson
13. *Phoma andina* Turkensteen
14. *Phyllosticta solitaria* Ell. et Ev.
15. *Septoria lycopersici* Speg. var. *malagutii* Ciccarone et Boerema
16. *Synchytrium endobioticum* (Schilbersky) Percival
17. *Thecaphora solani* Barrus
18. *Tilletia indica* Mitra

Trechispora brinkmannii (Bresad.) Rogers

(d) Viruse dhe organizma të ngjashëm si viruse

1. Elm phloem necrosis mycoplasm
2. Viruset e patates dhe organizma si viruset, të tilla si:
 - (a) Andean potato latent virus
 - (b) Andean potato mottle virus
 - (c) Arracacha virus B, oca strain
 - (d) Potato black ringspot virus
 - (e) Potato spindle tuber viroid
 - (f) Potato virus T
 - (g) Izolate joeuropiane të viruseve të patates A, M, S, V, X dhe Y (përfshirë Yo, Yn dhe Yc) dhe Potato leaf roll virus
3. Tobacco ringspot virus
4. Tomato ringspot virus
5. Viruse dhe organizma si viruse tek *Cydonia* Mill., *Fragaria* L., *Malus* Mill., *Prunus* L., *Pyrus* L., *Ribes* L., *Rubus* L. and *Vitis* L., të tilla si:
 - (a) Blueberry leaf mottle virus
 - (b) Cherry rasp leaf virus (Amerikan)
 - (c) Peach mosaic virus (Amerikan)
 - (d) Peach phony rickettsia
 - (e) Peach rosette mosaic virus
 - (f) Peach rosette mycoplasm
 - (g) Peach X-disease mycoplasm
 - (h) Peach yellows mycoplasm
 - (i) Pear decline mycoplasm
 - (j) Plum line pattern virus (amerikan) (k) Raspberry leaf curl virus (amerikan) (l) Strawberry latent "C" virus (m) Strawberry vein banding virus (n) Strawberry witches' broom mycoplasm
 - (o) Viruse dhe organizma siviliruse, joeuropiane, te *Cydonia* Mill., *Fragaria* L., *Malus* Mill., *Prunus* L., *Pyrus* L., *Ribes* L., *Rubus* L. and *Vitis* L.

6. Viruse të transmetuara nga Bemisia tabaci Genn., të tilla si:

- (a) Bean golden mosaic virus
 - (b) Cowpea mild mottle virus
 - (c) Lettuce infectious yellows virus
 - (d) Pepper mild tigre virus
 - (e) Squash leaf curl virus
 - (f) Euphorbia mosaic virus
 - (g) Florida tomato virus
- (e) Bimë parazite
1. Arceuthobium spp. (joeuropean)

SEKSIONI 2

PARAZITË QË JANË HASUR NË TERRITORIN E SHQIPËRISË

(a) Insekte, këpusha dhe nematode në të gjitha stadet e zhvillimit të tyre

1. Heliothis armigera (Hubner)
2. Liriomyza bryoniae (Kaltenbach)
3. Liriomyza huidobrensis (Blanchard)
4. Liriomyza trifolii (Burgess)
5. Frankinella occidentalis (Pergande)

(b) Baktere

(c) Kërpuhda

(d) Viruse dhe organizma të ngjashëm si viruse

1. Apple proliferation mycoplasm
2. Apricot chlorotic leafroll mycoplasm

ANEKSI II

PJESA A

PARAZITË, HYRJJA DHE PËRHAPJA E TË CILËVE BRENDË TERRITORIT TË SHQIPËRISË ËSHTË E NDALUAR, NËSE ATO GJENDEN NË BIMË OSE PRODUKTE BIMORE TË CAKTUARA

SEKSIONI 1

PARAZITË QË NUK JANË HASUR NË TERRITORIN E SHQIPËRISË

a) Insekte, këpusha dhe nematode në të gjitha stadet e zhvillimit të tyre

Speciet Subjektet që kontaminohen

1. Aculops fuchsiae Keifer Bimët e Fuchsia L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat

2. *Aleurocanthus* spp. Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
3. *Anthonomus bisignifer* (Schenkling) Bimët e *Fragaria* L., për mbjellje, të ndryshme nga farat
4. *Anthonomus signatus* (Say) Bimët e *Fragaria* L., për mbjellje, të ndryshme nga farat
5. *Aonidiella citrina* Coquillett *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
6. *Aphelenchoides besseyi* Christie Farat e *Oryza* spp.
Bimët e *Fragaria* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
7. *Aschistonyx eppoi* Inouye Bimët *Juniperus* L., të ndryshme nga frutat dhe farat, me origjinë nga vendet joeuropiane
8. *Bursaphelenchus xylophilus* (Steiner et Buhrer) Nickle et al. Bimët e *Abies* Mill., *Cedrus* Trew, *Larix* Mill., *Picea* A. Dietr., *Pinus* L., *Pseudotsuga* Carr. and *Tsuga* Carr., të ndryshme nga frutat dhe farërat dhe druri i konifereve (Coniferales), me origjinë nga vendet joeuropiane
9. *Carposina niponensis* Walsingham Bimët e *Cydonia* Mill., *Malus* Mill., *Prunus* L. dhe *Pyrus* L., të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet joeuropiane
10. *Cephalcia larichifila* (klug) Bimët e *Larix* Mill. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
11. *Circulifer haematoceps* Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat e farat
12. *Circulifer tenellus* Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat e farat
13. *Diaphorina citri* Kuway Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre; dhe *Murraya* Konig, të ndryshme nga frutat dhe farërat
14. *Enarmonia packardii* (Zeller) Bimët e *Cydonia* Mill., *Malus* Mill., *Prunus* L. dhe *Pyrus* L., të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet joeuropiane
15. *Enarmonia prunivora* Walsh Bimët e *Crataegus* L., *Malus* Mill., *Photinia* Ldl., *Prunus* L. dhe *Rosa* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farërat dhe frutat e *Malus* Mill. dhe *Prunus* L., me origjinë nga vendet joeuropiane
16. *Eotetranychus lewisi* McGregor Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
17. *Eutetranychus orientalis* Klein Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat e farat
18. *Grapholita inopinata* Heinrich Bimët e *Cydonia* Mill., *Malus* Mill., *Prunus* L. dhe *Pyrus* L., të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet joeuropiane
19. *Hishomonus phycitis* Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
20. *Leucaspis japonica* Ckll. Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
21. *Listronotus bonariensis* (Kuschel) Farat e Cruciferae, Gramineae dhe *Trifolium* spp., me

originë nga Argjentina, Australia, Bolivia, Kili, Zelanda e Re dhe Uruguai.

22. *Margarodes*, speciet joeuropiane, të tilla si:

(a) *Margarodes vitis* (Phillipi)

(b) *Margarodes vredendalensis* de Klerk

(c) *Margarodes prieskaensis* Jakubski Bimët e *Vitis* L., të ndryshme nga frutat dhe farat

23. *Numonia pyrivorella* (Matsumura) Bimët e *Pyrus* L., të ndryshme nga farat, me originë nga vendet joeuropiane

24. *Oligonychus perditus* Pritchard et Baker Bimët e *Juniperus* L., të ndryshme nga frutat dhe farat, me originë nga vendet joeuropiane

25. *Pissodes* spp. (joeuropiane) Bimët e konifereve (Coniferales) të ndryshme nga frutat dhe farat, druri i konifereve (Coniferales) me lëkurë dhe lëkura e veçuar e konifereve (Coniferales), me originë nga vendet joeuropiane

26. *Radopholus citrophilus* Huettel Dickson et Kaplan Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre të ndryshme nga frutat dhe farat dhe bimët e Araceae, Marantaceae, Musaceae, *Persea* spp., Strelitziaceae, të rrënjëzuara ose me terren mbjellës të bashkangjitur ose shoqërues

27. *Radopholus similis* (Cobb) Thorne Bimët e Araceae, Marantaceae, Musaceae, *Persea* spp., Strelitziaceae, të rrënjëzuara ose me terren rritës të bashkuara ose të shoqëruara

28. *Saissetia nigra* (Nietm.) Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat

29. *Scirtothrips aurantii* Faure Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga farat

30. *Scirtothrips dorsalis* Hood Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat

31. *Scirtothrips citri* (Moultext) Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga farat

32. *Scolytidae* spp. (specie joeuropiane) Bimët e konifereve (Coniferales), mbi 3 m në gjatësi, të ndryshme nga frutat dhe farat, druri i konifereve (Coniferales) me lëkurë, dhe lëkura e veçuar e konifereve (Coniferales), me originë nga vendet joeuropiane

33. *Tachypterellus quadrigibbus* Say Bimët e *Cydonia* Mill., *Malus* Mill., *Prunus* L. dhe *Pyrus* L., të ndryshme nga farat, me originë nga vendet joeuropiane

34. *Toxoptera citricida* Kirk. Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat

35. *Trioza erytrae* Del Guercio Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, dhe *Clausena* Burm.f., të ndryshme nga frutat dhe farat

36. *Unaspis citri* Comstock Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat

(b) Baktere

Speciet Subjektet që kontaminohen

1. *Citrus greening bacterium* Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
2. *Citrus variegated chlorosis* Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
3. *Clavibacter michiganensis* spp. *insidiosus* (McCulloch) Davis et al. Farat e *Medicago sativa* L.
4. *Curtobacterium flaccumfaciens* pv. *flaccumfaciens* (Hedges) Collins and Jones Farat e *Phaseolus vulgaris* L. dhe *Dolichos* Jacq.
5. *Erwinia stewartii* (Smith) Dye Farat e *Zea mais* L.
6. *Erwinia chrysanthemi* pv. *dianthicola* (Hellmers) Dickey Bimët e *Dianthus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
7. *Pseudomonas caryophylli* (Burkholder) Starr et Burkholder Bimët e *Dianthus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
8. *Pseudomonas syringae* pv. *persicae* (Prunier et al.) Young et al. Bimët e *Prunus persica* (L.) Batsch dhe *Prunus persica* var. *nectarina* (Ait.) Maxim, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
9. *Xanthomonas campestris* (të gjitha shtamet patogjenike mbi *Citrus*) Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga farat
10. *Xanthomonas campestris* pv. *Oryzae* (Ishiyama) Dye dhe pv. *oryzicola* (Fang et al.) Dye Farat e *Oryza* spp me origjinë nga vendet joeuropiane
11. *Xanthomonas campestris* pv. *Phaseoli* (Smith) Dye Farat e *Phaseolus* L.
12. *Xanthomonas campestris* pv. *pruni* (Smith) Dye Bimët e *Prunus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
13. *Xylophilus ampelinus* (Panagopoulos) Willems et al. Bimët e *Vitis* L., të ndryshme nga frutat dhe farat

(c) Kërpudha

Speciet Subjektet që kontaminohen

1. *Alternaria alternata* (Fr.) Keissler (isolatet patogjenike joeuropiane) Bimët e *Cydonia* Mill., *Malus* Mill. and *Pyrus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet joeuropiane
 - 1.1. *Anisogramma anomala* (Peck) E. Muller Bimët e *Corylus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës
2. *Apiosporina morbosa* (Schwein.) v. Arx Bimët e *Prunus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
3. *Atropellis* spp. Bimët e *Pinus* L., të ndryshme nga frutat dhe farat, lëkura e veçuar dhe druri i *Pinus* L.
4. *Ceratocystis coerulescens* (Munch) Bakshi Bimët e *Acer saccharum* Marsh., të ndryshme nga frutat dhe farat, me origjinë nga vendet e Amerikës së Veriut, druri i *Acer saccharum* Marsh., përfshirë drurin që nuk ka sipërfaqen e tij natyrore, me origjinë nga vendet e Amerikës së Veriut

5. *Ceratocystis fimbriata* f. spp. platani Walter Bimët e Platanus L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, dhe druri i Platanus L., përfshirë drurin që nuk ka ruajtur sipërfaqe në të natyrore të rrumbullakët
6. *Ceratocystis virescens* (Davidson) Moreau Bimët e *Acer saccharum* Marsh., të ndryshme nga frutat dhe farat, me origjinë nga SHBA-ja dhe Kanadaja, druri i *Acer saccharum* Marsh., përfshirë drurin, i cili nuk ka sipërfaqen e tij natyrore të rrumbullakët, me origjinë nga SHBA-ja dhe Kanadaja
7. *Cercoseptoria pini-densiflorae* (Hori and Nambu) Deighton Bimët e *Pinus* L., të ndryshme nga frutat dhe farat dhe druri i *Pinus* L.
8. *Cercospora angolensis* Carv. and Mendes Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga farat
9. *Ciborinia camelliae* Kohn Bimët e *Camellia* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet joeuropiane
10. *Colletotrichum acutatum* Simmonds Bimët e *Fragaria* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
11. *Diaporthe vaccinii* Shaer Bimët e *Vaccinium* spp., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
12. *Didymella ligulicola* (Baker, Dimock and Davis) v. Arx Bimët e *Dendranthema* (DC.) Des Moul., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
13. *Elsinoe* spp. Bitanc. and Jenk. Mendes Bimët e *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat dhe bimët e *Citrus* L. dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga farat dhe frutat përveç frutave të *Citrus reticulata* Blanco dhe të *Citrus sinensis* (L.) Osbeck, me origjinë nga Amerika e Jugut
14. *Fusarium oxysporum* f. sp. *Albedinis* (Kilian and Maire) Gordon Bimët e *Phoenix* spp., të ndryshme nga frutat dhe farat
15. *Guignardia citricarpa* Kiely (të gjitha shtamet patogjenike mbi bimët *Citrus*) Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga farat
16. *Guignardia piricola* (Nosa) Yamamoto Bimët e *Cydonia* Mill., *Malus* Mill., *Prunus* L. dhe *Pyrus* L., të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet joeuropiane
17. *Hypoxyton mammatum* (Wahl.) J. Miller Bimët e *Populus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
18. *Phialophora cinerescens* (Wollenweber) van Beyma Bimët e *Dianthus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
19. *Phoma tracheiphila* (Petri) Kanchaveli and Gikashvili Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga farat
20. *Phytophthora fragariae* Hickmann var. *fragariae* Bimët e *Fragaria* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
21. *Puccinia pittieriana* Hennings Bimët *Solanaceae*, të ndryshme nga frutat dhe farat
22. *Scirrhia acicola* (Dearn.) Siggers Bimët e *Pinus* L., të ndryshme nga frutat dhe farat

23. *Venturia nashicola* Tanaka and Yamamoto Bimët e *Pyrus L.*, të planifikuara për mbjelle, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet joeuropiane
- (d) Viruse dhe organizma të ngjashëm si viruse
- Speciet Subjektet që kontaminohen
1. Arabis mosaic virus Bimët e *Fragaria L.* and *Rubus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
 2. Beet curly top virus (isolate joeuropiane) Bimët e *Beta vulgaris L.*, të planifikuara për mbjelle, të ndryshme nga farat
 3. Beet leaf curl virus Bimët e *Beta vulgaris L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat.
 4. Black raspberry latent virus Bimët e *Rubus L.*, të planifikuara për mbjellje
 5. Blight and blight-like Bimët e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
 6. Cadang-Cadang viroid Bimët e *Palmae*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet joeuropiane
 7. Cherry leafroll virus Bimët e *Rubus L.*, të planifikuara për mbjellje
 8. Citrus mosaic virus Bimët e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
 9. Chrysanthemum stunt viroid Bimët e *Dendranthema (DC.) Des Moul.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
 10. Citrus tristeza virus (izolatet joeuropiane) Bimët e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
 11. Citrus vein enation woody gall Bimët e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
 12. Grapevine flavescence doree MLO Bimët e *Vitis L.*, të ndryshme nga frutat dhe farat
 13. Leprosis Bimët e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
 14. Little cherry pathogen (izolatet joeuropiane) Bimët e *Prunus cerasus L.*, *Prunus avium L.*, *Prunus incisa Thunb.*, *Prunus sargentii Rehd.*, *Prunus serrula Franch.*, *Prunus serrulata Lindl.*, *Prunus speciosa (Koidz.) Ingram*, *Prunus subhirtella Miq.*, *Prunus yedoensis Matsum.*, dhe hibridet dhe kultivarët e tyre, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
 15. Naturally spreading psorosis Bimët e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
 16. Palm lethal yellowing mycoplasma Bimët e *Palmae*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet joeuropiane
 17. *Prunus necrotic ringspot virus* Bimët e *Rubus L.*, të planifikuara për mbjellje
 18. Raspberry ringspot virus Bimët e *Fragaria L.* dhe *Rubus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
 19. Satsuma dwarf virus Bimët e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
 20. *Spiroplasma citri* Saglio et al. Bimët e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe

hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat

21. Strawberry crinkle virus Bimët e *Fragaria L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
22. Strawberry latent ringspot virus Bimët e *Fragaria L.* dhe *Rubus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
23. Strawberry mild yellow edge virus Bimët e *Fragaria L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
24. Tatter leaf virus. Bimët e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
25. Tomato black ring virus Bimët e *Fragaria L.* dhe *Rubus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
26. Tomato spotted wilt virus Bimët e *Apium graveolens L.*, *Capsicum annuum L.*, *Cucumis melo L.*, *Dendranthema (DC.) Des Moul.*, të gjitha varietetet e hibrideve të Guinesë së Re *Impatiens*, *Lactuca sativa L.*, *Lycopersicon lycopersicum (L.) Karsten ex Farw.* *Nicotiana tabacum L.*, për të cilat është evidentuar që ato janë planifikuar për shitje për prodhim profesional të duhanit. *Solanum melongena L.* dhe *Solanum tuberosum L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
27. Tomato yellow leaf curl virus Bimët e *Lycopersicon lycopersicum (L.) Karsten ex Farw.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
28. Witches' broom (MLO) Bimët e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat

SEKSIONI 2

PARAZITË QË JANË HASUR NË TERRITORIN E SHQIPËRISË

(a) Insekte, këpusha dhe nematode në të gjitha stadet e zhvillimit të tyre

Speciet Subjektet që kontaminohen

1. *Anthonomus grandis (Boh.) Fara* dhe fruta (boce) *Gossypium spp.* dhe pambuk të pazhveshur
2. *Cephalcia lariciphila (Klug)* Bimët e *Larix Mill.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
3. *Daktulosphaira vitifoliae (Fitch)* Bimët e *Vitis L.*, të ndryshme nga fruta dhe farat
4. *Dendroctonus micans Kugelan* Bimët e *Abies Mill.*, *Larix Mill.*, *Picea A. Dietr.*, *Pinus L.* dhe *Pseudotsuga Carr.*, mbi 3 m të gjatë, të ndryshëm nga frutat dhe farat, druri i konifereve (Coniferales) me lëvore, lëvore e veçuara e konifereve
5. *Ditylenchus destructor Thorne* Bulbat e luleve dhe kokrrat e *Crocus L.*, kultivaret miniature dhe hibridet e tyre të gjinisë *Gladiolus Tourn. ex L.*, të tilla si: *Gladiolus callianthus Marais*, *Gladiolus colvillei Sweet*, *Gladiolus nanus hort.*, *Gladiolus ramosus hort.*, *Gladiolus tubergenii hort.*, *Hyacinthus L.*, *Iris L.*, *Tigridia Juss.*, *Tulipa L.*, të planifikuara për mbjellje dhe tuberet e patates (*Solanum tuberosum L.*), të planifikuara për mbjellje
6. *Ditylenchus dipsaci (Kuhn) Filipjev* Farat dhe bulbat e *Allium ascalonicum L.*, *Allium*

cepa L. dhe *Allium schoenoprasum* L. të planifikuara për mbjellje dhe bimët e *Allium porrum* L. të planifikuara për mbjellje, bulbat dhe kokrrat e *Camassia* Lindl., *Chionodoxa* Boiss., *Crocus flavus* Weston "Golden Yellow", *Galanthus* L., *Galtonia candicans* (Baker) Decne, *Hyacinthus* L., *Ismene* Herbert, *Muscari* Miller, *Narcissus* L., *Ornithogalum* L., *Puschkinia* Adams, *Scilla* L., *Tulipa* L., të planifikuara për mbjellje dhe farat e *Medicago sativa* L.

7. *Gilphinia hercyniae* (Hartig) Bimët e *Picea* A. Dietr., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat

8. *Gonipterus scutellatus* Gyll Bimët e of *Eucalyptus* l'Herit., të ndryshme nga frutat dhe farat

9. (a) *Ips amitinus* Eichhof Bimët e *Abies* Mill., *Larix* Mill., *Picea* A. Dietr. Dhe *Pinus* L., mbi 3 m të gjata, të ndryshme nga frutat dhe farat, druri i konifereve (Coniferales) me lëvore, lëvore e veçuar e konifereve

(b) *Ips cembrae* Heer Bimët e *Abies* Mill., *Larix* Mill., *Picea* A. Dietr. dhe *Pinus* L. dhe *Pseudotsuga* Carr., mbi 3 m të gjata, të ndryshme nga frutat dhe farat, druri i konifereve (Coniferales) me lëvore, lëvore e veçuar e konifereve

(c) *Ips duplicatus* Sahlberg Bimët e *Abies* Mill., *Larix* Mill., *Picea* A. Dietr. dhe *Pinus* L., mbi 3 m të gjata, të ndryshme nga frutat dhe farat, druri i konifereve (Coniferales) me lëvore, lëvore e veçuar e konifereve

(d) *Ips sexdentatus* Börner Bimët e *Abies* Mill., *Larix* Mill., *Picea* A. Dietr. Dhe *Pinus* L., mbi 3 m të gjata, të ndryshme nga frutat dhe farat, druri i konifereve (Coniferales) me lëvore, lëvore e veçuar e konifereve

(e) *Ips typographus* Heer Bimët e *Abies* Mill., *Larix* Mill., *Picea* A. Dietr. dhe *Pinus* L. dhe *Pseudotsuga* Carr., mbi 3 m të gjata, të ndryshme nga frutat dhe farat, druri i konifereve (Coniferales) me lëvore, lëvore e veçuar e konifereve

10. *Liriomyza huidobrensis* (Blanchard) Lule të prera, perime gjethore të *Apium graveolens* L. dhe bimë të specieve barishtore, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga: bulba t, kokrrat, bimët e familjes Graminaceae, rizomat, farat

11. *Liriomyza trifolii* (Burgess). Lule të prera, perime gjethore të *Apium graveolens* L. dhe bimë të specieve barishtore, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga: bulbat, kokrrat, bimët e familjes Graminaceae, rizomat, farat

12. *Sternochetus mangiferae* Fabricius Farat e *Mangifera* spp. me origjinë nga vendet e treta

13. *Thaumatococcus panyocampa* (Den. And Schiff.) Bimët e *Pinus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga frutat dhe farat

(b) Baktere

Speciet Subjektet që kontaminohen

1. *Clavibacter michiganensis* spp. *michiganensis* (Smith) Davis et al. Bimët e *Lycopersicon lycopersicum* (L.) Karsten ex Farw., të planifikuara për mbjellje

2. *Erwinia amylovora* (Burr.) Winsl. et al. Bimët e *Amelanchier* Med., *Chaenomeles* Lindl., *Cotoneaster* Ehrh., *Crataegus* L., *Cydonia* Mill., *Eriobotrya* Lindl., *Malus* Mill., *Mespilus* L., *Photinia davidiana* (Dcne.) Cardot, *Pyracantha* Roem., *Pyrus* L. dhe *Sorbus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat

3. *Xanthomonas campestris* pv. *vesicatoria* (Doidge) Dye Bimët e *Lycopersicon lycopersicum* (L.) Karsten ex Farw. dhe *Capsicum* spp., të planifikuara për mbjellje
4. *Xanthomonas fragariae* Kennedy and King Bimët e *Fragaria* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat

(c) Kërpudha

Speciet Subjektet që kontaminohen

1. *Cryphonectria parasitica* (Murrill) Barr. Bimët e *Castanea* Mill and *Quercus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
2. *Glomerella gossypii* Edgerton Farat dhe frutat (bocet) e *Gossypium* spp.
3. *Gremmeniella abietina* (Lag.) Morelet Bimët e *Abies* Mill., *Larix* Mill., *Picea* A. Dietr., *Pinus* L. dhe *Pseudotsuga* Carr., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
4. *Hypoxyton mammatum* (Wahl.) J. Miller Bimët e *Populus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
5. *Plasmopara halstedii* (Farlow) Berl. and de Toni Farat e *Helianthus annuus* L.
6. *Scirrhia pini* Funk and Parker Bimët e *Pinus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
7. *Verticillium albo-atrum* Reinke and Berthold Bimët e *Humulus lupulus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
8. *Verticillium dahliae* Klebahn Bimët e *Humulus lupulus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat

(d) Viruse dhe organizma të ng jashëm si viruse

Speciet Subjektet që kontaminohen

4. *Citrus tristeza virus* (izolatet europiane) Bimët e *Citrus* L., *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat
7. *Plum pox virus* Bimët e *Prunus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat
8. *Potato stolbur mycoplasma* Bimët e *Solanaceae*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat

ANEKSI III

PJESA A

BIMË, PRODUKTE BIMORE DHE OBJEKTE TË TJERA, HYRJA E TË CILAVE ËSHTË E NDALUAR NË TË GJITHË TERRITORIN E SHQIPËRISË

Përshkrimi Vendi i origjinës

1. Bimët e *Abies* Mill., *Cedrus* Trew, *Chamaecyparis* Spach, *Juniperus* L., *Larix* Mill., *Picea* A. Dietr., *Pinus* L., *Pseudotsuga* Carr. dhe *Tsuga* Carr., të ndryshme nga frutat dhe farat
Vendet joeuropiane
2. Bimët e *Castanea* Mill., dhe *Quercus* L., me gjethe, të ndryshme nga frutat dhe farat
Vendet joeuropiane
3. Bimët e *Populus* L., me gjethe, të ndryshme nga frutat dhe farat
Vendet amerikano-veriore

4. Fshirë
5. Lëvore e veçuara e *Castanea Mill.* Vendet joanëtare të BE-së
6. Lëvore e veçuar e *Quercus L.*, e ndryshme nga *Quercus suber L.* Vendet amerikano-veriore
7. Lëvore e veçuara e *Acer saccharum Marsh.* Vendet amerikano-veriore
8. Lëvore e veçuar e *Populus L.* Vendet e kontinentit amerikan
9. Bimët e *Chaenomeles L.*, *Cydonia Mill.*, *Crateagus L.*, *Malus Mill.*, *Prunus L.*, *Pyrus L.*, dhe *Rosa L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga bimët e fjetura pa gjethe, lule dhe fruta Vendet joeuropiane
- 9.1. Bimët e *Photinia L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga bimët e fjetura pa gjethe, lule dhe fruta SHBA-ja, Kina, Japonia, Republika e Koresë dhe Republika Demokratike Popullore e Koresë
10. Tuberë të *Solanum tuberosum L.*, farë patatesh Vendet joanëtare të BE-së, të ndryshme nga Zvicra
11. Bimët e specieve stolon- ose tuber- formuese të *Solanum L.* ose hibridet e tyre, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme prej atyre tuberve të *Solanum tuberosum L.* siç specifikohet në aneksin IIIA(10) Vendet joanëtare të BE-së
12. Tuberet e specieve të *Solanum L.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshme prej atyre të specifikuara në pikat (10), (11) Pa cenuar kërkesat e veçanta të aplikuara për tuberet e patates së listuar në aneksin IV, pjesa A, seksioni I, vendet joanëtare të BE-së, përveç Algjerisë, Egjiptit, Izraelit, Libisë, Morokut, Sirisë, Zvicrës, Tunizisë dhe Turqisë, dhe përveç vendeve joanëtare të BE-së, edhe pse njihen të pastra prej *Clavibacter michiganensis ssp. sepedonicus* (Spieckermann et Kotthoff) Davis et al., edhe nëse ato aplikojnë kushtet të njohura si ekuivalente me BE-në për luftimin e *Clavibacter michiganensis ssp. sepedonicus* (Spieckermann et Kotthoff) Davis et al .
13. Bimët e *Solanaceae*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat dhe çështjet që mbulon aneksi III A (10), (11) ose (12) Vendet joanëtare të BE-së, të ndryshme nga vendet europiane dhe mesdhetare
14. Tokë dhe terren rritës, që përbëhet tërësisht ose pjesërisht prej toke ose substanca organike, të tilla si pjesë të bimëve, humusi përfshirë torfë ose lëkurë, të ndryshme nga torfa e dekompozuar plotësisht. Turqia, Bjellorusia, Moldavia, Rusia, Ukraina dhe vendet joanëtare të BE-së që nuk i takojnë Europës kontinentale, përveç: Egjiptit, Izraelit, Libisë, Morokut, Tunizisë.
15. Plants of *Vitis L.*, të ndryshme nga frutat Vendet joanëtare të BE-së, përveç Zvicrës
16. Bimët e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshme prej frutave dhe farave Vendet joanëtare të BE-së
17. Bimët e *Phoenix spp.*, të ndryshme nga frutat dhe farat Algjeria, Maroku
18. Bimët e *Cydonia Mill.*, *Malus Mill.*, *Prunus L.* dhe *Pyrus L.* dhe hibridet e tyre dhe *Fragaria L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat Pa cenuar ndalimet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III A (9), ku përkatësisht vendet joeuropiane, përveç vendeve mesdhetare, Australisë, Zelandës së

Re, Kanadasë, dhe shtetet kontinentale të SHBA-së

19. Bimët e familjes Graminaceae, të ndryshme nga bimët zbukuroese barëra shumëvjeçare të nënfamiljes Bambusoideae dhe Panicoideae dhe të gjinive Buchloe, Bouteloua Lag., Calamagrostis, Cortaderia Stapf., Glyceria R.Br., Hakonechloa Mak. ex Honda, Hystrix, Molinia, Phalaris L., Shibataea, Spartina Schreb., Stipa L. dhe Uniola L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat Vendet joanëtare të BE-së, përveç vendeve europiane dhe mesdhetare

ANEKSI IV

PJESA A

KËRKESA TË VEÇANTA, TË CILAT DUHET TË ZBATOHEN PËR HYRJEN DHE LËVIZJEN E BIMËVE, PRODUKTEVE BIMORE DHE OBJEKTEVE TË TJERA NË SHQIPËRI

SEKSIONI 1

BIMË, PRODUKTE BIMORE DHE OBJEKTE TË TJERA ME ORIGJINË JASHTË SHQIPËRISË

Bimët, produktet bimore dhe objekte të tjera Kërkesa të veçanta

1.1. Është listuar apo jo në kodet CN në aneksin V, pjesa B, druri i konifereve (Coniferales), përveç atij të Thuja L., i ndryshëm nga:

- ashkla, copëza, pluhur sharre, tallash, mbeturina druri, ose copëra të përfutuara tërësisht ose pjesërisht nga këto konifere,
- material ambalazhi prej druri në formë arkash ambalazhi, kutish, koshash, çikrikësh dhe ambalazhe të ngjashme, paleta, paleta kuti dhe dërrasa të tjera ngarkese, koshave tip palete, që përdoren aktualisht në transportin e objekteve të të gjitha llojeve, dru i përdorur për të ndarë ose mbështetur ngarkesë (kargo) me material jodrusor,
- dru i Libocedrus decurrens Torr., ku evidentohet që druri është procesuar ose është përdorur për prodhimin e lapsave, duke përdorur trajtim me nxehtësi për të arritur një minimum temperature prej 82 °C për një periudhë prej 7-8 ditë, por duke përfshirë atë që ruan sipërfaqen e tij natyrore, me origjinë nga Kanadaja, Kina, Japonia, Republika e Koresë, Meksika, Tajvani dhe SHBA-ja, ku dihet që Bursaphelenchus xylophilus (Steiner et Buhrer) Nickle et al. është prezent. Deklarim zyrtar që druri i është nënshtruar një trajtimi përkatës përmes: trajtimit me nxehtësi për të arritur një minimum temperaturë të zëmrës prej 56°C për të paktën 30 minuta. Kjo duhet të jetë evidentuar me anë të një stampe 'HT' të vendosur mbi dru ose mbi çdo material paketimi në pajtim me përdorimin tregtar të kohës, dhe në certifikatat që i referohen artikullit 13.1.(ii), ose fumigimit sipas një specifike të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. Duhet të jenë evidentuar në certifikatat që i referohen artikullit 13.1. (ii), lënda aktive,

minimumi i temperaturës së drurit, raporti (g/m³) dhe koha e ekspozimit në orë (h); ose impenjimit kimik me presion me një produkt të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. Në certifikatat që i referohen artikullit 13.1. (ii), duhet të jenë evidentuar lënda aktive, presioni (psi ose kPa) dhe koncentrimi (%).

1.2. Është listuar apo jo në kodet CN në aneksin V, pjesa B, druri i konifereve (Coniferales), përveç atij të Thuja L., në formë:

ashkle, copëze, pluhur sharre, tallashi, mbeturinash druri dhe skrap të përfutuara tërësisht ose pjesërisht prej këtyre konifereve,

me origjinë nga Kanadaja, Kina, Japonia, Republika e Koresë, Meksika, Taivani dhe SHBA-ja, ku

Bursaphelenchus xylophilus (Steiner et Buhrer) Nickle et

al. dihet që është prezent. Deklarim zyrtar që druri i është nënshtruar një trajtimi përkatës përmes:

trajtimin me nxehtësi për të arritur një minimum temperaturë të zemrës prej 56°C për të paktën 30 minuta; trajtimi i fundit duhet të tregohet në certifikatat që referohen i artikullit 13.1.(ii); ose

fumigimit sipas një specifike të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. Duhet të jenë evidentuar në certifikatat që i referohen artikullit 13.1. (ii), lënda aktive, minimumi i temperaturës së drurit, raporti (g/m³) dhe koha e ekspozimit në orë (h).

1.3. Është listuar apo jo ndër kodet CN në aneksin V, pjesa B, druri i Thuja L., i ndryshëm nga dru në formën e:

- ashklave, copëzave, pluhur sharre, tallash, mbeturina druri dhe skrap druri,

- material ambalazhi prej druri, në formën e arkave të ambalazhit, kutive, koshave, çikrikëve dhe materialeve të ngjashme të paketimit, paletave, paletave kuti dhe dërrasave të tjera ngarkese, koshave tip paletë; që përdoren aktualisht në transportin e objekteve të çdo lloji,

- drurit të përdorur për ndarjen ose mbështetjen e kargos me material jodrusor,

me origjinë nga Kanadaja, Kina, Japonia, Republika e Koresë, Meksika, Tajvani dhe SHBA-ja, ku dihet që *Bursaphelenchus xylophilus* (Steiner et Buhrer) Nickle et Deklarimi zyrtar që druri: Është i qëruar, pa lëvore; ose

i është nënshtruar procesit të thajjes në furrë (kiln drying) për të arritur lagështinë nën 20%, e shprehur si një përqindje e lëndës së thatë, e siguruar përmes zbatimit të një skede përkatëse të raportit kohë/temperaturë. Kjo duhet të jetë evidentuar me anë të një stampe "kiln dried" (tharë në furrë) ose "KD", ose ndonjë stampë tjetër të njohur në nivel ndërkombëtar, të vendosur mbi dru ose mbi çdo material ambalazhi, në pajtim me përdorimin tregtar të kohës; ose i është nënshtruar një trajtimi përkatës me nxehtësi për të arritur një temperaturë të zemrës 56°C për të paktën 30 minuta. Kjo duhet të jetë evidentuar me anë të një stampe "HT" të vendosur mbi dru ose mbi çdo material ambalazhi, në pajtim me përdorimin tregtar të kohës dhe në certifikatat që i referohen artikullit 13.1.(ii); ose

al. është prezent. furnizimit sipas një specifike të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. Duhet të jenë evidentuar në certifikatat që i referohen artikullit

13.1 (ii), lënda aktive, minimumi i temperaturës së drurit, raporti (g/m³) dhe koha e ekspozimit në orë (h); ose i është nënshtruar një impenjimi përkatës kimik me presion me një produkt të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. Duhet të jenë evidentuar në certifikatat që i referohen artikullit 13.1. (ii), lënda aktive, presioni (psi ose kPa) dhe koncentrimi në (%).

1.4. Është listuar apo jo ndër kodet CN në aneksin V, pjesa B, druri i Thuja L., në formën e: - ashklave, copëzave, pluhur sharre, tallash, mbeturina druri dhe skrap druri, me origjinë Kanadaja, Kina, Japonia, Republika e Koresë, Meksika, Tajvani dhe SHBA-ja, ku dihet që *Bursaphelenchus xylophilus* (Steiner et Buhner) Nickle et al. është prezent.

Deklarimi zyrtar që druri:

- (a) është prodhuar nga druri i rrumbullakët i qëruar nga lëvorja; ose
- (b) i është nënshtruar tharjes në furrë nën një lagështi 20%, e shprehur si një përqindje e lëndës së thatë, e arritur përmes zbatimit të një skede përkatëse kohë/temperaturë; ose
- (c) i është nënshtruar një furnizimi përkatës sipas një specifike të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. Duhet të jenë evidentuar në certifikatat që i referohen artikullit 13. 1. (ii), lënda aktive, temperature minimale e drurit, raporti (g/m³) dhe koha e ekspozimit në orë (h); ose
- (d) i është nënshtruar një trajtimi përkatës me nxehtësi për të arritur një temperaturë të zemrës 560C për të paktën 30 minuta, trajtimi i fundit duhet të tregohet në certifikatat që i referohen artikullit 13.1.(ii).

1.5. Është listuar apo jo në kodet CN në aneksin V, pjesa B, druri i konifereve (Coniferales), i ndryshëm nga:

- ashkla, copëza, pluhur sharre, tallash, mbeturina druri ose copëra të përftuara tërësisht ose pjesërisht nga këto konifere,
- material ambalazhi prej druri në formë arkash ambalazhi, kutish, koshash, çikrikëve dhe ambalazhe të ngjashme, paleta, paleta kuti dhe dërrasa të tjera ngarkese, koshave tip palete, që përdoren aktualisht në transportin e objekteve të të gjitha llojeve,
- druri i përdorur për ndarjen ose mbështetjen e kargos me material jo drusor, por duke përfshirë atë që nuk ka ruajtur sipërfaqen natyrore të rrumbullakët të tij, me origjinë nga Rusia, Kazakistani dhe Turqia Deklarimi zyrtar që druri:

(a) është me origjinë nga zona të njohura si të pastra nga:

- *Monochamus* spp. (joeuropiane)
- *Pissodes* spp. (joeuropiane)
- *Scolytidae* spp. (joeuropiane)

Zona duhet të jetë shënuar në certifikatat që i referohen artikullit 13.1.(ii), në rubrikën "vendi i origjinës"; ose

(b) është i qëruar prej lëvores dhe i pastër nga vrimat e larvave, të shkaktuara nga gjinia *Monochamus* spp. (joeuropiane), të përcaktuara për këtë qëllim, ato që janë më të mëdha se 3 mm në seksion tërthor; ose

(c) i është nënshtruar procesit të tharjes në furrë (kiln-drying) për të arritur lagështinë nën 20%, e shprehur si një përqindje e lëndës së thatë, e siguruar përmes zbatimit të një skede

përkatëse të raportit kohë/temperaturë. Kjo duhet të jetë evidentuar me anë të një stampe "kiln dried" (tharë në furrë) ose "KD", ose ndonjë stampë tjetër të njohur në nivel ndërkombëtar, të vendosur mbi dru ose mbi çdo material ambalazhi, në pajtim me përdorimin tregtar të kohës; ose

(d) i është nënshtruar një trajtimi përkatës me nxehtësi për të arritur një temperaturë të zemrës 560C për të paktën 30 minuta. Kjo duhet të jetë evidentuar me anë të një stampe "HT" të vendosur mbi dru, ose mbi çdo material ambalazhi, në pajtim me përdorimin tregtar të kohës dhe në certifikatat që i referohen artikullit 13.1.(ii); ose

(e) i është nënshtruar një fumigimi përkatës sipas një specifike të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. Duhet të jenë evidentuar në certifikatat që i referohen artikullit 13. 1. (ii), lënda aktive, temperaturë minimale e drurit, raporti (g/m³) dhe koha e ekspozimit në orë (h); ose

(f) i është nënshtruar një impenjimi përkatës kimik me prison me një produkt të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. duhet të jenë evidentuar në certifikatat që i referohen artikullit 13.1. (ii), lënda aktive, presioni (psi ose kPa) dhe koncentrimi në (%). 1.6. Është listuar apo jo në kodet CN në aneksin V, pjesa B, druri i konifereve (Coniferales), i ndryshëm nga: - ashkla, copëza, pluhur sharre, tallash, mbeturina druri, Deklarimi zyrtar që druri:

(a) Është i qëruar prej lëvores dhe i pastër nga vrimat e larvave, të shkaktuara nga gjinia *Monochamus* spp.

ose copëra të përfutuara tërësisht ose pjesërisht nga këto konifere,

- material ambalazhi prej druri në formë arkash ambalazhi, kutish, koshash, çikrikëve dhe ambalazhe të ngjashme, paleta, paleta kuti dhe dërrasa të tjera ngarkese, koshave tip palete, që përdoren aktualisht në transportin e objekteve të të gjitha llojeve,
- druri i përdorur për ndarjen ose mbështetjen e kargos me material jodrusor, por duke përfshirë atë që nuk ka ruajtur sipërfaqen natyrore të rrumbullakët të tij, me origjinë nga vendet e trata (joanëtare të BE-së), të ndryshëm nga:

- Rusia, Kazakistan dhe Turqia vendet europiane

- Kanadaja, Kina, Japonia, Republika e Koresë, Meksika, Tajvani dhe SHBA-ja, ku dihet që *Bursaphelenchus xylophilus* (Steiner et Buhner) Nickle et al. është prezent. (joeuropiane), të përcaktuara për këtë qëllim, ato që janë më të mëdha se 3 mm në seksion tërthor; ose

(b) i është nënshtruar procesit të tharjes në furrë (kiln-drying) për të arritur lagështinë nën 20%, e shprehur si një përqindje e lëndës së thatë, e siguruar përmes zbatimit të një skede përkatëse të raportit kohë/temperaturë. Kjo duhet të jetë evidentuar me anë të një stampe "kiln dried" (tharë në furrë), ose "KD", ose ndonjë stampë tjetër të njohur në nivel ndërkombëtar, të vendosur mbi dru ose mbi çdo material ambalazhi, në pajtim me përdorimin tregtar të kohës; ose

(c) i është nënshtruar një fumigimi përkatës sipas një specifike të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. Duhet të jenë evidentuar në certifikatat që i referohen artikullit 13. 1. (ii), lënda aktive, temperature minimale e drurit, raporti (g/m³) dhe

koha e ekspozimit në orë (h); ose

(d) i është nënshtruar një impenjimi përkatës kimik me prision me një produkt të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. duhet të jenë evidentuar në certifikatat që i referohen artikullit 13.1. (ii), lënda aktive, presioni (psi ose kPa) dhe koncentrimi në (%); ose

(e) i është nënshtruar një trajtimi përkatës me nxehtësi për të arritur një temperaturë të zemrës 560C për të paktën 30 minuta. Kjo duhet të jetë evidentuar me anë të një stampe "HT" të vendosur mbi dru, ose mbi çdo material ambalazhi, në pajtim me përdorimin tregtar të kohës dhe në certifikatat që i referohen artikullit 13.1.(ii).

1.7. Është listuar apo jo në kodet CN në aneksin V, pjesa B, dru në formë ashkla, copëza, pluhur sharre, tallash, mbeturina druri dhe skrap druri të përfutuara tërësisht ose pjesërisht nga koniferet (Coniferales), me origjinë nga:

- Rusia, Kazakistani dhe Turqia
- Vendet joeuropiane të ndryshme nga Kanadaja, Kina, Japonia, Republika e Koresë, Meksika, Tajvani dhe SHBA-ja, ku dihet që *Bursaphelenchus xylophilus* (Steiner et Buhner) Nickle et al. është prezent. Deklarimi zyrtar që druri:

(a) është me origjinë nga zona të njohura si të pastra nga:

- *Monochamus* spp. (joeuropiane)
- *Pissodes* spp. (joeuropiane)
- *Scolytidae* spp. (joeuropiane)

Zona duhet të jetë shënuar në certifikatat që i referohen Artikullit 13.1.(ii), në rubrikën "vendi i origjinës"; ose (b) është prodhuar nga dru i rrumbullakët prej të cilit lëvorja është qëruar; ose

(c) i është nënshtruar procesit të tharjes në furrë (kiln-drying) për të arritur lagështinë nën 20%, e shprehur si një përqindje e lëndës së thatë, e siguruar përmes zbatimit të një skede përkatëse të raportit kohë/temperaturë; ose

(d) i është nënshtruar një fumigimi përkatës sipas një specifike të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. Duhet të jenë evidentuar në certifikatat që i referohen artikullit 13. 1. (ii), lënda aktive, temperaturë minimale e drurit, raporti (g/m³) dhe koha e ekspozimit në orë (h); ose

(e) i është nënshtruar një trajtim përkatës me nxehtësi për të arritur një temperaturë të zemrës 560C për të paktën 30 minuta. Trajtimi i fundit duhet të jetë treguar në certifikatat që i referohen artikullit 13.1.(ii).

2. Materiali ambalazh prej druri, në formë arkash ambalazhi, kutish, koshash, çikrikëve dhe ambalazhe të ngjashme, paleta, paleta kuti dhe dërrasa të tjera ngarkese, koshave tip paletë, që përdoren aktualisht në transportin e objekteve të të gjitha llojeve, përveç drurit të pa përpunuar me trashësi 6 mm ose më pak dhe drurit të procesuar të prodhuar me ngjitet (tutkall), nxehtë dhe shtypje, ose me kombinim të tyre, që vjen nga vendet e treta, përveç Zvicrës. Materiali ambalazh prej druri duhet:

- të jetë bërë prej druri të rrumbullakët dhe të qëruar prej lëvores, dhe
- të jetë subjekt i njëjës nga masat e aprovuara siç është specifikuar në aneksin I të standardit

ndërkombëtar për masat fitosanitare nr.15, nxjerrë nga FAO, me titull: Udhëzues për rregullat për materialin ambalazh prej druri në tregtinë ndërkombëtare, dhe - të tregojë një stampë me:

(a) kodin e vendit ISO prej dy germash (p.sh., Shqipëria = AL), një kod që identifikon prodhuesin dhe kodi identifikues i mënyrës së aprovuar të dezinfektimit që është zbatuar në materialin ambalazh prej druri në stampën siç është specifikuar në aneksin II të standardit ndërkombëtar për masat fitosanitare nr.15, nxjerrë nga FAO, me titull: Udhëzues për 7569

rregullat për materialin ambalazh prej druri në tregtinë ndërkombëtare. Germat "DB" duhet të shtohen te shkurtimi i masës së aprovuar, të përfshirë në stampën e thënë më sipër; dhe (b) gjithashtu logon siç është specifikuar në aneksin II të Standardit të FAO të thënë më sipër, në rastin kur materiali ambalazh prej druri është prodhuar, riparuar ose ricikluar pas 1 marsit 2005. Megjithatë, kërkesa nuk është e zbatueshme përkohësisht deri më 31 dhjetor 2007 në rastin e materialit ambalazh prej druri të prodhuar, riparuar ose të ricikluar para 28 shkurtit 2005.

Kryeradha e parë, që kërkon që materiali ambalazh prej druri të jetë bërë me dru të rrumbullakët dhe të qëruar prej lëvores, do të zbatohet nga 1 janari 2009. Ky paragraf do të rishihet më 1 shtator 2007.

2.1. Dru i *Acer saccharum* Marsh., duke përfshirë drurin që nuk ka ruajtur sipërfaqen natyrore të rrumbullakët të tij, i ndryshëm nga druri në formën e:

- dru i parashikuar për prodhimin e fletëve të rimesos,
- ashkla, copëza, pluhur sharre, tallash, mbeturina druri dhe skrap druri, me origjinë nga SHBA-ja dhe Kanadaja. Deklarimi zyrtar që druri i është nënshtruar procesit të tharjes në furrë (kiln-drying) për të arritur lagështinë nën 20%, e shprehur si një përqindje e lëndës së thatë, e siguruar përmes zbatimit të një skede përkatëse të raportit kohë/temperaturë. Kjo duhet të jetë e evidentuar me anë të një stampe "kiln dried" (tharë në furrë), ose "KD", ose ndonjë stampë tjetër të njohur në nivel ndërkombëtar, të vendosur mbi dru ose mbi çdo material ambalazhi, në pajtim me përdorimin tregtar të kohës.

2.2. Dru i *Acer saccharum* Marsh., parashikuar për prodhimin e fletëve të rimesos, me origjinë nga SHBA-ja dhe Kanadaja. Deklarimi zyrtar që druri është me origjinë nga zona të njohura si të pastra nga *Ceratocystis virescens* (Davidson) Moreau dhe është parashikuar për prodhimin e fletëve të rimesos.

3. Dru i *Quercus L.*, i ndryshëm nga druri në formën e:

- ashklave, copëzave, pluhurit të sharrës, tallashit, mbeturinave dhe skrapit të drurit,
- bucelace, fucive, kadeve, vaskave dhe produkteve të tjera të vozapunuesit dhe pjesët prej druri, përfshirë rripat e vozave, ku evidentohet në mënyrë të dokumentuar që druri është prodhuar apo fabrikuar duke përdorur trajtim me nxehtësi për të arritur një minimum temperature prej 1760C për 20 minuta, por duke përfshirë drurin, i cili nuk ka ruajtur sipërfaqen e rrumbullakët natyrore të tij, me origjinë nga SHBA-ja. Deklarimi zyrtar që druri: (a) është bërë me formë katrore aq sa ka humbur plotësisht sipërfaqen e rrumbullakët; ose

(b) është i qëruar prej lëvores dhe përmbajtja e ujit është nën 20%, e shprehur kjo si një përqindje ndaj lëndës së thatë; ose

(c) është i qëruar prej lëvores dhe është dezinfektuar me anë të një trajtimi përkatës me ajër të nxehtë ose ujë të nxehtë; ose

(d) nëse është sharruar, me ose pa mbeturina të lëvores së mbetur në dru, i është nënshtruar procesit të tharjes në furrë (kiln-drying) për të arritur lagështinë nën 20%, e shprehur si një përqindje e lëndës së thatë, e siguruar përmes zbatimit të një skede përkatëse të raportit kohë/temperaturë. Kjo duhet të jetë evidentuar me anë të një stampe "kiln dried" (tharë në furrë), ose "KD", ose ndonjë stampë tjetër të njohur në nivel ndërkombëtar, të vendosur mbi dru ose mbi çdo material ambalazhi, në pajtim me përdorimin tregtar të kohës.

4.

5. Dru i Platanus L., përveç atij në formën e ashklave, copëzave, pluhurit të sharrës, tallashit, mbeturinave dhe skrapit të drurit, por përfshirë drurin, i cili nuk ka ruajtur sipërfaqen e rrumbullakë natyrore të tij, me origjinë nga SHBA-ja ose Armenia. Deklarim zyrtar që druri i është nënshtruar procesit të tharjes në furrë (kiln-drying) për të arritur lagështinë nën 20%, e shprehur si një përqindje e lëndës së thatë, e siguruar përmes zbatimit të një skede përkatëse të raportit kohë/temperaturë. Kjo duhet të jetë evidentuar me anë të një stampe "kiln dried" (tharë në furrë), ose "KD", ose ndonjë stampë tjetër të njohur në nivel ndërkombëtar, të vendosur mbi dru ose mbi çdo material ambalazhi, në pajtim me përdorimin tregtar të kohës

6. Dru i Populus L., përveç atij në formën e ashklave, copëzave, pluhurit të sharrës, tallashit, mbeturinave dhe skrapit të drurit, por përfshirë drurin që nuk e ka ruajtur sipërfaqen e rrumbullakët natyrore të tij, me origjinë nga kontinenti amerikan. Deklarim zyrtar që druri:

- është i qëruar prej lëvores; ose

- që druri i është nënshtruar procesit të tharjes në furrë (kiln-drying) për të arritur lagështinë nën 20%, e shprehur si një përqindje e lëndës së thatë, e siguruar përmes zbatimit të një skede përkatëse të

raportit kohë/temperaturë. Kjo duhet të jetë evidentuar me anë të një stampe "kiln dried" (tharë në furrë), ose "KD", ose ndonjë stampë tjetër të njohur në nivel ndërkombëtar, të vendosur mbi dru ose mbi çdo

7570

material ambalazhi, në pajtim me përdorimin tregtar të kohës.

7.1. Është i listuar apo jo në kodet CN në aneksin V, Pjesa B, druri në formën e ashklave, copëzave, pluhurit të sharrës, tallashit, mbeturinave dhe skrapit të drurit, të përfituara tërësisht ose pjesërisht nga:

- Acer saccharum Marsh., me origjinë nga SHBA-ja dhe Kanadaja,

- Platanus L., me origjinë nga SHBA-ja ose Armenia,

- Populus L., me origjinë nga kontinenti amerikan. Deklarimi zyrtar që druri:

është prodhuar nga dru i rrumbullakët e i qëruar prej lëvores; ose

i është nënshtruar procesit të tharjes në furrë (kiln-drying) për të arritur lagështinë nën 20%, e shprehur si një përqindje e lëndës së thatë, e siguruar përmes zbatimit të një skede përkatëse të raportit kohë/temperaturë; ose i është nënshtruar një fumigimi përkatës sipas një specifikë

të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. Duhet të jenë evidentuar në certifikatat që i referohen artikullit 13. 1. (ii), lënda aktive, temperaturë minimale e drurit, raporti (g/m³) dhe koha e ekspozimit në orë (h); ose i është nënshtruar një trajtimi përkatës me nxehtësi për të arritur një temperaturë të zemrës 560C për të paktën 30 minuta, trajtimi i fundit duhet të jetë treguar në certifikatat që i referohen artikullit 13.1(ii)

7.2. Është i listuar apo jo në kodet CN në aneksin V, pjesa B, druri në formën e ashklave, copëzave, pluhurit të sharrës, tallashit, mbeturinave dhe skrapit të drurit, të përfituara tërësisht ose pjesërisht prej *Quercus L.* me origjinë nga SHBA-ja. Deklarimi zyrtar që druri: i është nënshtruar procesit të thajjes në furrë (kiln-drying) për të arritur lagështinë nën 20%, e shprehur si një përqindje e lëndës së thatë, e siguruar përmes zbatimit të një skede përkatëse të raportit kohë/temperaturë; ose i është nënshtruar një fumigimi përkatës sipas një specifikë të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. Duhet të jenë evidentuar në certifikatat që i referohen artikullit 13.1(ii), lënda aktive, temperature minimale e drurit, raporti (g/m³) dhe koha e ekspozimit në orë (h); ose i është nënshtruar një trajtimi përkatës me nxehtësi për të arritur një temperaturë të zemrës 560C për të paktën 30 minuta. Trajtimi i fundit duhet të jetë treguar në certifikatat që i referohen artikullit 13.1(ii).

7.3. Lëvore e veçuar e konifereve (Coniferales), me origjinë nga vendet joeuropiane.

Deklarimi zyrtar që lëvorja e veçuar:

ka qenë subjekt i një fumigimi përkatës me një fumigant të miratuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18.2. Duhet të jenë evidentuar në certifikatat që i referohen artikullit 13. 1. (ii), lënda aktive, temperaturë minimale e drurit, raporti (g/m³) dhe koha e ekspozimit në orë (h); ose i është nënshtruar një trajtimi përkatës me nxehtësi për të arritur një temperaturë të zemrës 560C për të paktën 30 minuta, trajtimi i fundit duhet të jetë treguar në certifikatat që i referohen artikullit 13.1(ii).

8. Druri i përdorur për të ndarë ose mbështetur ngarkesë jomaterial drusor, përfshi atë që nuk ka ruajtur formën e tij natyrore të rumbullakët, përveç drurit të papërpunuar me trashësi 6 mm ose më pak dhe drurin e përpunuar, të prodhuar me ngjitje, nxehtësi dhe shtypje ose një kombinim të tyre, që vjen nga vendet e treta, përveç Zvicrës. Druri duhet:

(a) është prodhuar nga dru i rumbullaket e i qëruar prej lëvores; dhe

- të jetë subjekt i një prej masave të miratuara siç është specifikuar në aneksin I të standardit ndërkombëtar për masat fitosanitare (ISPM) nr.15 nxjerrë nga FAO, me titull:

Udhëzues për rregullat për materialin ambalazh prej druri në tregtinë ndërkombëtare; dhe

- të tregojë një stampë me të paktën dy germat ISO të kodit të vendit, një kod identifikues të prodhuesit dhe kodin identifikues të metodës së miratuar që është zbatuar mbi materialin ambalazh prej druri, siç është specifikuar në aneksin II të standardit ndërkombëtar për masat fitosanitare (ISPM)

nr. 15 nxjerrë nga FAO, me titull: Udhëzues për rregullat për materialin ambalazh prej druri në tregtinë ndërkombëtare. Germat "DB" duhet të shtohen si shkurtime të masës së miratuar në stampën e sipërpërmendur, ose mbi një bazë të përkohshme deri më 31 dhjetor 2007;

(b) të jetë bërë nga dru i qëruar prej lëvores dhe që është i pastër nga parazitët dhe shenjat e dëmtuesve të gjallë.

Rreshti i parë i pikës (a), ku kërkohet që materiali ambalazh prej druri të jetë bërë nga dru i rrumbullakët, i qëruar prej lëvores, do të zbatohet vetëm nga 1 janari 2009. Ky paragraf do të rishikohet më 1 shtator 2007.

8.1. Bimët konifere (Coniferales), të ndryshme nga frutat dhe farat me origjinë nga vendet joeuropiane. Pa cenuar ndalesat e aplikueshme, përkatësisht për bimët e listuara në aneksin III (A) (1), deklarimi zyrtar që bimët janë prodhuar në fidanishte dhe që vendi i prodhimit është i pastër nga *Pissodes* spp. (joeuropiane).

8.2. Bimët konifere (Coniferales), të ndryshme nga frutat dhe farat mbi 3 m. lartësi, me origjinë nga vende joeuropiane. Pa cenuar ndalesat e aplikueshme, përkatësisht për bimët e listuara në aneksin III (A) (1), dhe në aneksin IV (A) (I) (8.1), deklarimi zyrtar që bimët janë prodhuar në fidanishte dhe që vendi i prodhimit është i pastër nga *Scolytidae* spp. (joeuropiane).

9. Bimë *Pinus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III (A) (1), dhe në aneksin IV (A) (I) (8.1) (8.2), deklarimi zyrtar që simptoma të *Scirrhia acicola* (Dearn).Siggers ose *Scirrhia pini* Funk dhe Parker nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate të tij që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ.

10. Bimët e *Abies Mill.*, *Larix Mill.*, *Picea A. Dietr.*, *Pinus L.* *Pseudotsuga Carr. and Tsuga Carr.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III (A) (1) dhe në aneksin IV (A) (I) (8.1) (8.2) ose (9), deklarimi zyrtar që simptoma të *Melampsora medusae* Thumen nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate të tij që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ.

11.01. Bimët e *Quercus L.*, të ndryshme nga frutat e farat, me origjinë nga SHBA-ja. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III (A) (2), deklarimi zyrtar që bimët janë me origjinë nga zona të njohura si të pastra nga *Ceratocystis fagacearum* (Bretz) Hunt.

11.1. Bimët e *Castanea Mill.* dhe *Quercus L.*, të ndryshme nga frutat e farat me origjinë nga vende joeuropiane. Pa cenuar ndalesat e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III(A)(2) dhe IV (A)(I)(11.01.), deklarimi zyrtar që simptoma të *Cronartium* spp. (joeuropiane) nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate të tij që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ.

11.2. Bimët e *Castanea Mill.* dhe *Quercus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III(A)(2) dhe IV (A)(I)(11.1), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët janë me origjinë nga zona të njohura si të pastra nga *Cryphonectria parasitica* (Murrill) Barr; ose

(b) simptoma të *Cryphonectria parasitica* (Murrill) Barr nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate të tij që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ.

11.3. Bimët e *Corylus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga Kanadaja dhe SHBA-ja. Deklarimi zyrtar që bimët janë rritur në fidanishte, dhe:

(a) janë me origjinë nga një zonë e vendit eksportues e përcaktuar nga shërbimi kombëtar i mbrojtjes bimëve i atij vendi, si i pastër nga *Anisogramma anomala* (Peck) E. Muller, në pajtim me standardet ndërkombëtare për masat fitosanitare dhe që është përmendur në certifikatat e referuara në artikujt 7 dhe 8 të kësaj direktive në rubrikën "Deklarim shtesë"; ose

(b) janë me origjinë nga një vend prodhimi në vendin eksportues të përcaktuar nga shërbimi kombëtar i mbrojtjes bimëve i atij vendi, si i pastër nga *Anisogramma anomala* (Peck) E. Muller bazuar mbi inspektime zyrtare të kryera në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate të tij qysh nga fillimi i tri cikleve të plota vegetative të fundit, në pajtim me standardet ndërkombëtare për masat fitosanitare përkatëse, dhe që është përmendur në certifikatat e referuara në artikujt 7 dhe 8 të kësaj direktive në rubrikën "Deklarime shtesë" dhe deklaruar të pastra nga *Anisogramma anomala* (Peck) E. Muller.

12. Bimët e *Platanus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat me origjinë nga SHBA-ja ose Deklarimi zyrtar që simptoma të *Ceratocystis fimbriata* f. sp. *platani* Walter nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit ose në

Armenia. afërsi imediate të tij që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegetativ.

13.1. Bimët e *Populus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet e treta (joanëtare të BE-së). Pa cenuar ndalesat e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III(A)(3), deklarimi zyrtar që simptoma të *Melampsora medusae* Thumen, nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate të tij që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegetativ.

13.2. Bimët e *Populus L.*, të ndryshme nga frutat dhe farat, me origjinë nga vendet e kontinentit amerikan. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III (A) (3) dhe aneksin IV (A) (I) (13.1), deklarimi zyrtar që simptoma të *Mycosphaeraella populorum* G.E. Thompson, nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate të tij që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegetativ.

14. Bimët e *Ulmus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat me origjinë nga vendet e Amerikës së Veriut. Deklarimi zyrtar që simptoma të *Elm phloem necrosis mycoplasma* nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate të tij që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegetativ.

15. Bimët e *Chaenomeles Lindl.*, *Crataegus L.*, *Cydonia Mill.*, *Eriobotrya Lindl.*, *Malus Mill.*, *Prunus L.* and *Pyrus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet joeuropiane. Pa cenuar ndalesat e aplikueshme, përkatësisht për bimët e listuara në aneksin III(A) (9), (18) dhe aneksin III(B) (1), deklarimi zyrtar që:

- bimët janë me origjinë nga një vend i njohur që të jetë i pastër nga *Monilinia fructicola* (Winter) Honey; ose

- bimët janë me origjinë nga një zonë e pranuar që të jetë e pastër nga *Monilinia fructicola* (Winter) Honey, në pajtim me procedurën e referuar në artikullin 18(2) dhe simptoma të *Monilinia fructicola* (Winter) Honey, nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegetativ.

16. Nga 15 shkurti deri 30 shtator, frutat e *Prunus L.*, me origjinë nga vendet joeuropiane.

Deklarimi zyrtar:

- frutat janë me origjinë nga një vend i njohur që të jetë i pastër nga *Monilinia fructicola* (Winter) Honey; ose

- frutat të jenë me origjinë nga zona të pranuar që të jenë të pastra nga *Monilinia fructicola* (Winter) Honey, në pajtim me procedurën e referuar në artikullin 18(2); ose

- frutat kanë qenë subjekt i inspektimit përkatës dhe procedurave të trajtimeve para vjeljes dhe/ose eksportit, për të siguruar pastërti nga *Monilinia spp.*

16.1. Frutat e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, me origjinë nga vendet e treta (joanëtare të BE-së). Frutat nuk duhet të kenë bishta dhe gjethe, dhe paketimi duhet të mbajë stampën përkatëse të origjinës.

16.2. Frutat e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibrideve të tyre, me origjinë nga vendet e treta (joanëtare të BE-së). Pa cenuar kushtet e aplikueshme për frutat në aneksin IV(A)(I)(16.1), (16.3), (16.4) dhe (16.5), deklarimi zyrtar që:

(a) frutat janë me origjinë nga një vend i pranuar që të jetë i pastër nga *Xanthomonas campestris* (të gjitha shtamet patogjenike mbi *Citrus*), në pajtim me procedurën e referuar në artikullin 18(2), ose

(b) frutat janë me origjinë nga një zonë e pranuar që të jetë e pastër nga *Xanthomonas campestris* (të gjitha shtamet patogjenike mbi *Citrus*), në pajtim me procedurën e referuar në artikullin 18(2), dhe të përmendur në certifikatat e referuara në artikujt 7 ose 8 të kësaj direktive; ose

(c) për më tepër,

- në pajtim me një kontroll zyrtar dhe regjimin e ekzaminimit, simptoma të *Xanthomonas campestris campestris* (të gjitha shtamet patogjenike mbi *Citrus*), nuk janë vërejtur në fushën e prodhimit dhe në afërsi imediate me të që prej fillimit të ciklit të fundit vegjetativ; dhe asnjë nga frutat e vjela në fushën e prodhimit nuk ka shfaqur simptomat e *Xanthomonas campestris campestris* (të gjitha shtamet patogjenike mbi *Citrus*) dhe frutat kanë qenë subjekt i trajtimit me sodium orthophenylphenate, të përmendur në certifikatat e referuara në artikujt 7 ose 8 të kësaj direktive; dhe

frutat kanë qenë paketuar në qendra grumbullimi ose shpërndarjeje të regjistruara për këtë qëllim; ose - çdo sistem certifikimi, i pranuar si ekuivalent me kushtet e mësipërme, ka qenë në përputhje me procedurën e referuar në artikullin 18 (2).

16.3. Frutat e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibrideve të tyre, me origjinë nga vendet e treta (joanëtare të BE-së). Pa cenuar kushtet e aplikueshme për frutat në aneksin IV(A)(I)(16.1), (16.2), (16.4) dhe (16.5), deklarimi zyrtar që:

(a) frutat janë me origjinë nga një vend i pranuar që të jetë i pastër nga *Cercospora angolensis* Carv. et Mendes në pajtim me procedurën e caktuar në artikullin 18(2); ose

(b) frutat janë me origjinë nga një zonë e pranuar që të jetë e pastër nga *Cercospora angolensis* Carv. et Mendes, në pajtim me procedurën e caktuar në artikullin 18(2) dhe të përmendur në certifikatat e referuara në artikujt 7 ose 8 të kësaj direktive; ose

(c) simptoma të *Cercospora angolensis* Carv. et Mendes nuk janë vërejtur në fushën e prodhimit dhe në afërsi imediate të saj që prej fillimit të ciklit të fundit vegjetativ; dhe asnjë nga frutat e vjela në fushën e prodhimit nuk ka shfaqur simptoma të këtij organizmi, në ekzaminimin përkatës zyrtar.

16.4. Frutat e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshëm nga frutat e *Citrus aurantium L.*, me origjinë nga vendet e treta (joanëtare të BE-së). Pa cenuar kushtet e aplikueshme për frutat në aneksin IV(A)(I)(16.1), (16.2), (16.3) dhe (16.5), deklarimi zyrtar që:

(a) frutat janë me origjinë nga një vend i pranuar që të jetë i pastër nga *Guignardia citricarpa* Kiely (të gjitha shtamet patogjenike mbi *Citrus*), në pajtim me procedurë e vendosur në artikullin 18(2); ose

(b) frutat janë me origjinë nga një zonë e pranuar që të jetë e pastër nga *Guignardia citricarpa* Kiely (të gjitha shtamet patogjenike mbi *Citrus*), në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18(2), dhe të përmendur në certifikatat e referuara në artikujt 7 ose 8 të kësaj direktive; ose

(c) simptoma të *Guignardia citricarpa* Kiely (të gjitha shtamet patogjenike mbi *Citrus*), nuk janë vërejtur në fushën e prodhimit dhe në afërsi imediate të saj që prej fillimit të ciklit të fundit vegjetativ, dhe asnjë nga frutat e vjela në fushën e prodhimit nuk ka shfaqur simptoma të këtij organizmi, në ekzaminimin përkatës zyrtar; ose

(d) fruta janë me origjinë nga një fushë prodhimi që ka qenë subjekt i trajtimeve përkatëse kundër *Guignardia citricarpa* Kiely (të gjitha shtamet patogjenike mbi *Citrus*); dhe asnjë nga frutat e vjela në fushën e prodhimit nuk ka shfaqur simptoma të këtij organizmi, në ekzaminimin përkatës zyrtar.

16.5. Frutat e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, me origjinë nga vendet e treta (joanëtare të BE-së) ku Tephritidae (joeuropiane) dihet të jenë hasur mbi këto fruta. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për frutat në aneksin III(B)(2), (3), dhe aneksin IV(A)(I)(16.1), (16.2) dhe (16.3), deklarimi zyrtar që:

(a) frutat janë me origjinë nga zona të njohura që të jenë të pastra nga organizmi përkatës; ose, nëse kjo kërkesë nuk mund të plotësohet;

(b) shenja të organizmit përkatës nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit dhe në afërsi imediate me të, që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ, bazuar mbi inspektimet zyrtare të kryera së paku çdo muaj gjatë tre muajve të fundit para vjeljes, dhe asnjë nga frutat e vjela në vendin e prodhimit, nuk ka shfaqur shenja të organizmit përkatës, nga ekzaminimi përkatës zyrtar, ose nëse kjo kërkesë gjithashtu nuk mund të jetë plotësuar;

(c) në ekzaminimet përkatëse zyrtare mbi mostra përfaqësuese, frutat kanë treguar që të jenë të pastra nga organizmi përkatës në të gjitha fazat e zhvillimit të tyre vegjetativ; ose, nëse kjo kërkesë gjithashtu nuk mund të jetë plotësuar;

(d) frutat kanë qenë subjekt i trajtimit përkatës, ndonjë trajtimi të pranueshëm me avull të nxehtë, trajtim të ftohtë, ose trajtim

të menjëhershëm me ngrije, të cilat kanë treguar se janë efikase kundër organizmit përkatës

pa e dëmtuar frutën, dhe kur ato nuk janë të realizueshme, trajtim kimik aq sa të jetë i pranueshëm nga legjislati i komunitetit.

17. Bimët e *Amelanchier* Med., *Chaenomeles* Lindl., *Cotoneaster* Ehrh., *Crataegus* L., *Cydonia* Mill., *Eriobotrya*

Lindl., *Malus* Mill., *Mespilus* L., *Photinia davidiana* (Dcne.) Cardot, *Pyracantha* Roem., *Pyrus* L. dhe *Sorbus* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara përkatësisht në aneksin III(A)(9), (9.1), (18), aneksin III(B)(1) ose aneksin IV(A)(I)(15), deklarimi zyrtar:

(a) që bimët janë me origjinë nga vende të pranura që të jenë të pastra nga *Erwinia amylovora* (Burr.) Winsl. et al. në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18(2); ose

(b) që bimët janë me origjinë nga zona të pastra nga parazitët, të cilat janë krijuar të tilla në lidhje me *Erwinia amylovora* (Burr.) Winsl. et al. në pajtim me standardet ndërkombëtare mbi masat fitosanitare përkatëse dhe të pranura si të tilla në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18(2); ose

(c) që bimët në fushën e prodhimit dhe në afërsi imediate me të, që kanë shfaqur simptoma të *Erwinia amylovora* (Burr.) Winsl. et al., janë eliminuar.

18. Bimët e *Citrus* L., *Fortunella* Swingle, *Poncirus* Raf., dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat e farat dhe bimët e *Araceae*, *Marantaceae*, *Musaceae*, *Persea* spp. dhe *Strelitziaceae*, të rrënjëzuara, ose me terren rritës bashkëngjitur ose shoqëruar Pa cenuar ndalesat e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III (A) (16), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët janë me origjinë nga vende të njohura të jenë të pastra nga *Radopholus citrophilus* Huettel et al. dhe *Radopholus similis* (Cobb) Thorne; ose

(b) mostra përfaqësuese të tokës dhe rrënjëve nga vendi i prodhimit i janë nënshtruar që nga fillimi i ciklit të fundit të plotë vegetativ, testimi zyrtar nematologjik të paktën për *Radopholus citrophilus* Huettel et al. dhe *Radopholus similis* (Cobb) Thorne dhe janë gjetur në këto teste të pastra nga këta organizma.

19.1. Bimët e *Crataegus* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku *Phyllosticta solitaria* Ell. and Ev. dihet se është hasur. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III (A) (9) dhe (18), dhe aneksin IV (A) (I) (15) e (17), deklarimi zyrtar që simptoma të *Phyllosticta solitaria* Ell. and Ev. nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegetativ.

19.2. Bimët e *Cydonia* Mill., *Fragaria* L., *Malus* Mill., *Prunus* L., *Pyrus* L., *Ribes* L., *Rubus* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat me origjinë nga vende ku parazitët përkatës dihet që janë hasur mbi bimët e gjinive përkatëse Këta parazitë janë: - mbi *Fragaria* L.: *Phytophthora fragariae* Hickman, var. *fragariae*, *Arabidopsis mosaic virus*, *Raspberry ringspot virus*, *Strawberry crinkle virus*, *Strawberry latent ringspot virus*, *Strawberry mild yellow edge virus*, *Tomato black ring virus*, *Xanthomonas fragariae* Kennedy et King; mbi *Malus* Mill.:

Phyllosticta solitaria Ell. and Ev.; mbi *Prunus* L.:

Apricot chlorotic leafroll mycoplasma, *Xanthomonas campestris* pv. *prunus* (Smith) Dye, mbi *Prunus persica* (L.) Batsch:

Pseudomonas syringae pv. *persicae* (Prunier et al.) Young et al.; mbi *Pyrus* L.: *Phyllosticta solitaria* Ell. and Ev.; mbi *Rubus* L.: Arabis mosaic virus, Raspberry ringspot virus, Strawberry latent ringspot virus, Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III (A) (9) e (18) dhe aneksin IV (A) (I) (15) e (17), deklarimi zyrtar që simptoma të sëmundjeve të shkaktuara nga parazitët përkatës, nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit që nga fillimi i ciklit të fundit të plotë vegetativ.

Tomato black ring virus, mbi të gjitha speciet:
viruset dhe organizmat si-viruset, joeuropiane

20. Bimët e *Cydonia* Mill. dhe *Pyrus* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku Pear decline mycoplasma dihet se është hasur. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III(A) (9) e (18) dhe aneksin IV(A) (I) (15), (17) e (19.2), deklarimi zyrtar që bimët në vendin e prodhimit dhe në afërsi imediate të tij, të cilat kanë shfaqur simptoma duke krijuar dyshimin për kontaminim nga Pear decline mycoplasma, kanë qenë asgjësuar në atë vend gjatë tri cikleve të fundit të plota vegetative.

21.1. Bimët e *Fragaria* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku parazitët përkatës dihet që janë hasur

Këta parazitë janë:

Strawberry latent "C" virus,

Strawberry vein banding virus,

Strawberry witches' broom mycoplasma. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III(A)(18) dhe aneksin IV(A)(I)(19.2), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët, të ndryshme nga ato që janë rritur nga fara, kanë qenë:

gjithashtu të certifikuar zyrtarisht sipas një skeme certifikimi duke kërkuar që ato të kenë rrjedhur në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara, dhe që ka qenë subjekt i testimave zyrtarë të paktën për parazitët e përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës ose metoda ekuivalente dhe në këto teste, janë gjetur të pastra, nga këta parazitë; ose

të rrjedhura në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara dhe që ka qenë subjekt i testimit zyrtar për të paktën një herë brenda 3 cikleve të plota vegetative, të paktën për parazitët e përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës, ose metoda ekuivalente dhe që në këto teste janë gjetur të pastra nga këta parazitë;

(b) simptoma të sëmundjeve, të shkaktuara nga parazitët e përmendur nuk kanë qenë vërejtur në bimë në vendin e prodhimit, ose mbi bimë të ndjeshme në afërsi imediate me të, qysh prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegetativ.

21.2. Bimët e *Fragaria* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet ku *Aphelenchoides besseyi* Christie dihet se është hasur. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III(A)(18) dhe aneksin IV(A)(I)(19.2) dhe (21.1), deklarimi zyrtar që:

(a) gjithashtu, simptoma të *Aphelenchoides besseyi* Christie nuk janë vërejtur mbi bimë në vendin e prodhimit që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegetativ; ose

(b) në rastin e bimëve in vitro, bimët kanë rrjedhur nga bimë që plotësojnë kërkesat e seksionit (a) të kësaj pike, ose kanë qenë testuar zyrtarisht nga metoda të caktuara nematologjike dhe janë gjetur të pastra nga *Aphelenchoides besseyi* Christie.

21.3. Bimët e *Fragaria* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III(A)(18) dhe aneksin IV(A)(I)(19.2) dhe (21.1) e (21.2), deklarimi zyrtar që bimët janë me origjinë nga një zonë e njohur që të jetë e pastër nga *Anthonomus signatus* Say and *Anthonomus bisignifer* (Schenkling).

22.1. Bimët e *Malus* Mill. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku parazitët përkatës që përmenden, njihen të jenë hasur mbi *Malus* Mill. Parazitët përkatës janë: Cherry rasp leaf virus (Amerikan), Tomato ringspot virus. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III(A)(9) e (18), aneksin III(B)(1) dhe aneksin IV(A)(I)(15), (17) dhe (19.2), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët kanë qenë: gjithashtu të certifikuar zyrtarisht sipas një skeme certifikimi duke kërkuar që ato të kenë rrjedhur në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara, dhe që ka qenë subjekt i testeve zyrtare të paktën për parazitët e përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës ose metoda ekuivalente dhe në këto teste, janë gjetur të pastra, nga këta parazitë; ose

të rrjedhura në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara dhe që ka qenë subjekt i testimit zyrtar për të paktën një herë brenda 3 cikleve të plota vegjetative, të paktën për parazitët e përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës, ose metoda ekuivalente dhe që në këto teste janë

gjetur të pastra nga këta parazitë;

(b) simptoma të sëmundjeve të shkaktuara nga parazitët e përmendur nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, ose mbi bimë të ndjeshme në afërsi imediate me të që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ.

22.2. Bimët e *Malus* Mill. të planifikuara për mbjellje, me origjinë nga vendet ku dihet se është hasur apple proliferation mycoplasma. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III (A) (9) e (18), aneksin III (B) (I) dhe aneksin IV (A) (I) (15), (17),(19.2) dhe (22.1), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët janë me origjinë nga zona që njihen të jenë të pastra nga apple proliferation mycoplasma; ose

(b) (aa) bimët, të ndryshme nga ato të rritura nga farat kanë qenë:

gjithashtu të certifikuar zyrtarisht sipas një skeme certifikimi duke kërkuar që ato të kenë rrjedhur në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara, dhe që ka qenë subjekt i testeve zyrtare të paktën për Apple proliferation mycoplasma, duke përdorur indikatorët përkatës ose metoda ekuivalente dhe në këto teste, janë gjetur të pastra, nga ai parazit; ose

të rrjedhura në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara dhe që ka qenë subjekt i testimit zyrtar për të paktën një herë brenda 6 cikleve të plota vegjetative, të paktën për Apple proliferation mycoplasma, duke përdorur indikatorët përkatës ose metoda

ekuivalente dhe që në këto testime janë gjetur të pastra nga ai parazit; (bb) simptoma të sëmundjes shkaktuar nga Apple proliferation mycoplasma nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, ose në bimë të ndjeshme në afërsi imediate me të, që prej fillimit të tri cikleve të fundit të plota vegetative.

23.1. Bimët e specieve *Prunus L.* që vijojnë të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat me origjinë nga vendet ku Plum pox virus dihet se është hasur:

Prunus amygdalus Batsch,
Prunus armeniaca L.,
Prunus blireiana Andre,
Prunus brigantina Vill.,
Prunus cerasifera Ehrh.,
Prunus cistena Hansen,
Prunus curdica Fenzl and Fritsch.,
Prunus domestica ssp. *domestica* L.,
Prunus domestica ssp. *insititia* (L.) C.K. Schneid.,
Prunus domestica ssp. *italica* (Borkh.) Hegi.,
Prunus glandulosa Thunb.,
Prunus holosericea Batal.,
Prunus hortulana Bailey,
Prunus japonica Thunb.,
Prunus mandshurica (Maxim.) Koehne,
Prunus maritima Marsh.,
Prunus mume Sieb and Zucc.,
Prunus nigra Ait.,
Prunus persica (L.) Batsch,
Prunus salicina L.,
Prunus sibirica L.,
Prunus simonii Carr.,
Prunus spinosa L.,
Prunus tomentosa Thunb.,
Prunus triloba Lindl.,

Specie të tjera *Prunus L.* të ndjeshme ndaj Plum pox virus. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin III(A)(9) e (18) dhe aneksin IV(A)(I)(15) e (19.2), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët, të ndryshme nga ato që janë rritur nga fara, kanë qenë: gjithashtu të certifikuara zyrtarisht sipas një skeme certifikimi duke kërkuar që ato të kenë rrjedhur në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara, dhe që ka qenë subjekt i testeve zyrtare të paktën për Plum pox virus, duke përdorur indikatorët përkatës ose metoda ekuivalente dhe në këto testime, janë gjetur të pastra, nga ai parazit; ose të rrjedhura në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara dhe që ka qenë subjekt i testimit zyrtar për të paktën një herë brenda 3 cikleve të plota vegetative, të paktën

për Plum pox virus, duke përdorur indikatorët përkatës, ose metoda ekuivalente dhe që në këto testime janë gjetur të pastra nga ai parazit;

(b) simptoma të sëmundjes shkaktuar nga Plum pox virus, nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, ose në bimë të ndjeshme në afërsi imediate me të, që prej fillimit të tri cikleve të fundit të plota vegetativ e;

(c) bimët në vendin e prodhimit që kanë shfaqur simptoma të sëmundjeve të shkaktuara nga viruse të tjera ose patogjenë-si viruse, janë asgjësuar.

23.2. Bimët e Prunus L., të planifikuara për mbjellje (a) me origjinë nga vendet ku parazitët e mëposhtëm dihen se janë hasur mbi Prunus L.; Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara, përkatësisht në aneksin III(A)(9) e (18) ose aneksin IV(A)(I)(15), (19.2) dhe (23.1), deklarimi zyrtar që:

(a) me origjinë nga vendet ku parazitët e mëposhtëm dihen se janë hasur mbi Prunus L.;

(b) të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet ku parazitët përkatës të mëposhtëm dihet se janë hasur;

(c) të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet joeuropiane ku parazitët përkatës të mëposhtëm dihet se janë hasur;

Parazitët përkatës janë: për rastin në pikën (a): Tomato ringspot virus; Për rastin në pikën (b): Cherry rasp leaf virus (Amerikan), Peach mosaic virus (Amerikan), Peach phony rickettsia, Peach rosette mycoplasm, Peach yellows mycoplasm, Plum line pattern virus (Amerikan), Peach X-disease mycoplasm; Për rastin në pikën (c): - Little cherry pathogen. (a) bimët kanë qenë: gjithashtu të certifikuar zyrtarisht sipas një skeme certifikimi duke kërkuar që ato të kenë rrjedhur në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara, dhe që ka qenë subjekt i testeve zyrtare të paktën për parazitët përkatës të përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës ose metoda ekuivalente dhe në këto testime, janë gjetur të pastra, nga këta parazitë; ose

të rrjedhura në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara dhe që ka qenë subjekt i testimit zyrtar për të paktën një herë brenda 3 cikleve të plota vegetative, të paktën për parazitët përkatës të përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës, ose metoda ekuivalente dhe që në këto testime janë gjetur të pastra nga këta parazitë; (b) simptoma të sëmundjeve të shkaktuara nga parazitët përkatës të përmendur, nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, ose mbi bimë të ndjeshme në afërsi imediate me të, që prej fillimit të tri cikleve të fundit të plota vegetative.

24. Bimët e Rubus L., të planifikuara për mbjellje:

(a) me origjinë nga vende ku parazitët dihen që janë hasur mbi Rubus L.

(b) të ndryshme nga farat me origjinë nga vende ku parazitët përkatës të mëposhtëm dihen se janë hasur. Parazitët përkatës janë:

në rastin (a): Tomato ringspot virus, Black raspberry latent virus, Cherry leafroll virus, Prunus necrotic ringspot virus, në rastin (b):

Raspberry leaf curl virus (amerikan) Cherry rasp leaf virus (amerikan) Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin IV(A)(I)(19.2),

(a) bimët duhet të janë të pastra nga afidet, përfshirë edhe vezët e tyre;

(b) deklarimi zyrtar që: (aa) bimët kanë qenë:

gjithashtu të certifikuara zyrtarisht sipas një skeme certifikimi duke kërkuar që ato të kenë rrjedhur në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara, dhe që ka qenë subjekt i testeve zyrtare të paktën për parazitët përkatës të përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës ose metoda ekuivalente dhe në këto teste, janë gjetur të pastra, nga këta parazitë; ose

të rrjedhura në vijë të drejtpërdrejtë nga materiali i ruajtur në kushte të caktuara dhe që ka qenë subjekt i testimit zyrtar për të paktën një herë brenda 3 cikleve të plota vegjetative, të paktën për parazitët përkatës të përmendur, duke përdorur indikatorët përkatës, ose metoda ekuivalente dhe që në këto teste janë gjetur të pastra nga këta parazitë; (bb) simptoma të sëmundjeve të shkaktuara nga parazitët përkatës të përmendur, nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, ose mbi bimë të ndjeshme në afërsi imediate me të, që prej fillimit të cikleve të fundit të plota vegjetative.

25.1. Tuberët e *Solanum tuberosum* L., me origjinë nga vende ku *Synchytrium endobioticum* (Schilbersky) Percival dihet se është hasur. Pa cenuar ndalesat e aplikueshme për tuberat e listuar në aneksin III(A)(10), (11) dhe (12), deklarimi zyrtar që:

(a) tuberat janë me origjinë nga zona të njohura që të jenë të pastra nga *Synchytrium endobioticum* (Schilbersky) Percival (të gjitha racat të ndryshme nga Race 1, raca e zakonshme europiane), dhe simptoma të *Synchytrium endobioticum* (Schilbersky) Percival nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate me të që prej fillimit të një periudhe të mjaftueshme; ose

(b) masat për luftimin e *Synchytrium endobioticum* (Schilbersky) Percival në vendin e origjinës kanë qenë përputhur me masat e pranuar si ekuivalente në BE, në pajtim me procedurën e përcaktuar në artikullin 18(2)

25.2. Tuberët e *Solanum tuberosum* L. Pa cenuar kushtet e listuara në aneksin (A)(10), (11) e (12) dhe aneksin IV(A)(I)(25.1), deklarimi zyrtar që:

(a) tuberat janë me origjinë nga vende të njohura të jenë të pastra nga *Clavibacter michiganensis* ssp. *sepedonicus* (Spieckermann and Kotthoff) Davis et al.; ose

(b) masat për luftimin e *Clavibacter michiganensis* ssp. *sepedonicus* (Spieckermann and Kotthoff) Davis et al. në

vendin e origjinës kanë qenë përputhur me masat e pranuar si ekuivalente në BE, në pajtim me procedurën e përcaktuar në artikullin 18(2).

25.3. Tuberët e *Solanum tuberosum* L., të ndryshëm nga patatet e hershme, me origjinë nga vende ku *Potato spindle tuber viroid* dihet se është hasur. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për tuberët të listuara në aneksin III(A)(10), (11) e (12) dhe aneksin IV(A)(I)(25.1) dhe (25.2), ndalimin e aftësisë për mbirje.

25.4 Tubere të *Solanum tuberosum* L. të planifikuara për mbjellje. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për tuberët e listuar në aneksin III(A)(10), (11) e (12) dhe aneksin IV(A)(I)(25.1), (25.2) dhe (25.3), deklarimi zyrtar që tuberët janë me origjinë nga fusha të

njohura që të jenë të pastra nga *Globodera rostochiensis* (Wollenweber) Behrens dhe *Globodera pallida* (Stone) Behrens; dhe

(aa) gjithashtu, tuberët të jenë me origjinë nga zona ku *Pseudomanas solanacearum* (Smith) Smith dihet që nuk është hasur; ose

(bb) në zonat ku *Pseudomanas solanacearum* (Smith) Smith dihet që është hasur, tuberë janë me origjinë nga një vend prodhimi i gjetur i pastër nga *Pseudomanas solanacearum* (Smith) Smith, ose i konsideruar të jetë i pastër, si pasojë e implementimit të një procedure përkatëse me qëllim çrrënjësjes e *Pseudomanas solanacearum* (Smith) Smith që duhet të jetë përcaktuar në pajtim me procedurën e vendosur në artikullin 18(2); dhe

(cc) gjithashtu, tuberët janë me origjinë nga zona ku *Meloidogyne chitwoodi* Golden et al. (të gjitha populacionet) dhe *Meloidogyne fallax* Karssen dihet që nuk janë hasur; ose (dd) në zonat ku *Meloidogyne chitwoodi* Golden et al. (të gjitha populacionet) dhe *Meloidogyne fallax* Karssen dihet që janë hasur,

gjithashtu tuberët janë me origjinë nga një vend prodhimi, i cili është gjetur i pastër nga *Meloidogyne chitwoodi* Golden et al. (të gjitha populacionet) dhe *Meloidogyne fallax* Karssen bazuar mbi vrojtme vjetore të bimëve strehuese me anë të inspektimeve vizuale të bimëve bujtëse në kohë të caktuara dhe me anë të inspektimeve vizuale të tuberëve nga jashtë dhe nga brenda, duke i prerë tuberët pas vjeljes së bimëve të patates të rritur në vendin e prodhimit; ose pas vjeljes janë marrë mostra tuberësh me rastësi dhe janë kontrolluar për praninë e simptomave sipas një metode të caktuar, ose janë testuar në laborator, po ashtu janë inspektuar edhe vizualisht nga jashtë dhe duke i prerë tuberët, në kohë të caktuara, dhe në të gjitha rastet në kohën e mbylljes së paketimit ose kontejnerëve përpara tregtimit, në pajtim me direktivën e Këshillit të BE-së, 66/403/CEE e 14 qershorit 1996 mbi tregtimin e patates së farës dhe nga ka rezultuar që simptoma të *Meloidogyne chitwoodi* Golden et al. (të gjitha populacionet) dhe *Meloidogyne fallax* Karssen nuk janë gjetur.

25.5. Bimët e Solanaceae, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku Potato stolbur mycoplasma dihet se është hasur. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për tuberët, të listuara në aneksin III(A)(10), (11), (12) e (13) dhe aneksin IV(A)(I)(25.1), (25.2), (25.3) dhe (25.4), deklarimi zyrtar që simptoma të Potato stolbur mycoplasma nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegetativ.

25.6. Bimët e Solanaceae, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga tuberët e *Solanum tuberosum* L. dhe të ndryshëm nga farat e *Lycopersicon lycopersicum* (L.) Karsten ex Farw., me origjinë nga vende ku Potato spindle tuber viroid dihet se është hasur. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët, të listuara përkatësisht në aneksin III(A)(11), (13) dhe aneksin IV(A)(I)(25.5), deklarimi zyrtar që simptoma të Potato spindle tuber viroid nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegetativ.

25.7. Bimët e *Capsicum annuum* L., *Lycopersicon lycopersicum* (L.) Karsten ex Farw., *Musa* L., *Nicotiana* L. dhe *Solanum melongena* L., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat me origjinë nga vende ku Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët, të listuara përkatësisht në aneksin III(A)(11) e (13), dhe aneksin IV(A)(I)(25.5) e (25.6), deklarimi zyrtar që: (a) bimët janë me origjinë nga zona, të cilat janë gjetur të

Pseudomonas solanacearum (Smith) Smith dihet se është hasur. pastra nga *Pseudomonas solanacearum* (Smith) Smith; ose (b) simptoma të *Pseudomonas solanacearum* (Smith) Smith nuk janë vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit, që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ.

25.8. Tuberët e *Solanum tuberosum* L., të ndryshëm nga ata të planifikuar për mbjellje. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për tuberët, të listuar në aneksin III(A)(12) dhe aneksin IV(A)(I)(25.1), (25.2) e (25.3), deklarimi zyrtar që tuberët janë me origjinë nga zona në të cilat *Pseudomonas solanacearum* (Smith) Smith nuk dihet të jetë hasur.

26. Bimët e *Humulus lupulus* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat. Deklarimi zyr tar që simptoma të *Verticillium albo-atrum* Reinke and Berthold dhe *Verticillium dahliae* Klebahn nuk janë vërejtur mbi lupulus në vendin e prodhimit, që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ.

27.1. Bimët e *Dendranthema* (DC.) Des Moul., *Dianthus* L. dhe *Pelargonium* l'Herit. ex Ait., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat. Deklarimi zyrtar që:

(a) shenja të *Heliopsis armigera* Hubner ose *Spodoptera littoralis* (Boisd.) nuk janë vërejtur mbi lupulus në vendin e prodhimit, që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegjetativ; ose (b) bimët u janë nënshtruar trajtimeve përkatëse për mbrojtjen e tyre nga parazitët e përmendur.

27.2. Bimët e *Dendranthema* (DC.) Des Moul., *Dianthus* L. dhe *Pelargonium* l'Herit. ex Ait., të ndryshme nga farat. Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara në aneksin IV(A)(I)(27.1)

(a) shenja të *Spodoptera eridiana* Cramer, *Spodoptera frugiperda* Smith, ose *Spodoptera litura* (Fabricius) nuk janë vërejtur në vendin e prodhimit, që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegjetativ; ose

(b) bimët i janë nënshtruar trajtimeve përkatëse për mbrojtjen e tyre nga parazitët e përmendur.

28. Bimët e *Dendranthema* (DC.) Des Moul., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara në aneksin IV(A)(I)(27.1) dhe (27.2), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët janë fond jo më shumë se të gjeneracionit të tretë, kanë rrjedhur nga materiali që është gjetur i pastër nga *Chrysanthemum stunt viroid* gjatë testimeve virologjike, ose janë të rrjedhura direkt nga materiali prej të cilit një mostër përfaqësuese prej të paktën 10% ka qenë gjetur e pastër nga *Chrysanthemum stunt viroid* gjatë inspektimi zyrtar të kryer në kohën e lulëzimit;

(b) bimët ose copat:

kanë ardhur nga vende, të cilat janë inspektuar zyrtarisht të paktën çdo muaj, gjatë tre muajve para shpërndarjes dhe mbi të cilat asnjë simptomë e *Puccinia horiana* Hennings nuk është vërejtur gjatë asaj periudhe, dhe në afërsi imediate të të cilave asnjë simptomë e *Puccinia horiana* Hennings nuk është ditur të jetë hasur gjatë tre muajve para eksportit; ose i janë nënshtruar trajtimeve përkatëse kundër *Puccinia horiana* Hennings;

(c) në rastin e copave të pa rrënjëzuara, asnjë simptomë e *Didymella ligulicola* (Baker, Dimock and Davis) v. Arx nuk ishte vërejtur si mbi copat, ashtu dhe mbi bimët prej të cilave kishin rijedhur copat, ose që, në rastin e copave të rrënjëzuara, asnjë simptomë e *Didymella ligulicola* (Baker, Dimock and Davis) v. Arx ishte vërejtur si mbi copat, ashtu dhe mbi shtratin e rrënjëzimit.

29. Bimët e *Dianthus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat. Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara në aneksin IV(A)(I)(27.1) dhe (27.2), deklarimi zyrtar që: Bimët kanë rijedhur në vijë të drejtë nga bimët meme, të cilat janë gjetur të pastra nga *Erwinia chrysanthemi* pv. *dianthicola* (Hellmers) Dickey, *Pseudomonas caryophylli* (Burkholder) Starr and Burkholder dhe *Phialophora cinerescens* (Wollenw.) Van Beyma nga testimet zyrtare të miratuara, të kryera të paktën një herë brenda dy viteve të mëparshme, asnjë simptomë e parazitëve të mësipërm nuk është vërejtur mbi bimët.

30. Bulbat e *Tulipa L.* dhe *Narcissus L.*, të ndryshëm nga ata për të cilët evidentohet nga paketimi i tyre, ose nga mënyra të tjera, që ata janë planifikuar të shiten tek konsumatori i fundit jo i përfshirë në prodhimin profesional të luleve të prera. Deklarimi zyrtar që asnjë simptomë e *Ditylenchus dipsaci* (Kuhn) Filipjev nuk është vërejtur në bimë që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ.

31. Bimët e *Pelargonium L'Herit. ex Ait.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku *Tomato ringspot virus* dihet se është hasur: Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara në aneksin IV(A)(I)(27.1) dhe (27.2),

(a) ku *Xiphinema americanum* Cobb sensu lato (populacionet joeuropiane) ose vektorë të tjerë të *Tomato ringspot virus* nuk dihen të jenë hasur. Deklarimi zyrtar që bimët:

(a) kanë rijedhur direkt nga vendet e prodhimit, të njohura që janë të pastra nga *Tomato ringspot virus*; ose

(b) janë të një fondi jo më shumë se gjeneracioni i katërt, të rrjedhura nga bimë mëmë të gjetura të pastra nga *Tomato ringspot virus* sipas një sistemi zyrtar të aprovuar të testimit virologjik.

(b) ku *Xiphinema americanum* Cobb sensu lato

(populacionet joeuropiane) ose vektorë të tjerë të *Tomato ringspot virus* dihen se janë hasur. Deklarimi zyrtar që bimët:

(a) kanë rrjedhur direkt nga vendet e prodhimit të njohura që janë të pastra nga *Tomato ringspot virus* në tokë ose bimë; ose

(b) janë të një fondi jo më shumë se gjeneracioni i dytë, të rrjedhura nga bimë mëmë të gjetura të pastra nga *Tomato ringspot virus* sipas një sistemi zyrtar të aprovuar të testimit virologjik.

32.1. Bimë të specieve barishtore, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga:

bulbat,

drithi,

bimë të familjes Graminaceae,

rhizomat,
farërat ,
tuberët,

me origjinë nga vendet e treta (joanëtare të BE-së) ku *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch) dihen se janë hasur. Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara përkatësisht në aneksin IV, pjesa A, seksioni I(27.1), (27.2), (28) dhe (29), deklarimi zyrtar që bimët kanë qenë rritur në fidanishte dhe:

(a) janë me origjinë nga një zonë në vendin eksportues, I përcaktuar nga shërbimi nacional i mbrojtjes së bimëve në atë vend, si e pastër nga *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch) në pajtim me standardet ndërkombëtare përkatëse për masat fitosanitare dhe kjo është përmendur në certifikatat e referuara në artikujt 7 dhe 8 të kësaj direktive, në rubrikën "Deklarim shtesë"; ose

(b) janë me origjinë nga një zonë në vendin eksportues, e përcaktuar nga shërbimi nacional i mbrojtjes së bimëve në atë vend, si e pastër nga *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch) në pajtim me standardet ndërkombëtare përkatëse për masat fitosanitare dhe kjo është përmendur në certifikatat e referuara në artikujt 7 dhe 8 të kësaj direktive, në rubrikën "Deklarim shtesë" dhe janë deklaruar të pastra nga *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch) mbi bazën e inspektimeve zyrtare të kryera të paktën çdo muaj gjatë tre muajve të fundit para eksportimit; ose

(c) menjëherë para eksportimit kanë qenë subjekt i një trajtimi përkatës kundër *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch) dhe kanë qenë inspektuar zyrtarisht e janë gjetur të pastra nga *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch). Detaje mbi trajtimin duhet të jenë përmendur në certifikatat e referuara në artikujt 7 dhe 8 të kësaj direktive.

32.2. Lulet e prera të *Dendranthema* (DC) Des. Moul., *Dianthus* L., *Gypsophila* L. dhe *Solidago* L., dhe perimet gjethore të *Apium graveolens* L. dhe *Ocimum* L. Deklarimi zyrtar që lulet e prera dhe perimet gjethore: janë me origjinë nga një vend i pastër nga *Liriomyza sativae* (Blanchard) dhe *Amauromyza maculosa* (Malloch); ose menjëherë para eksportimit të tyre janë inspektuar zyrtarisht dhe janë gjetur të pastra nga *Liriomyza sativae* (Blanchard) and *Amauromyza maculosa* (Malloch).

32.3. Bimë të specieve barishtore, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga:

bulbat,
drithi,

bimë të familjes Graminaceae, Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara në aneksin IV, pjesa A, seksioni I(27.1), (27.2), (28), (29) dhe (32.1), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët janë me origjinë nga një zonë e njohur që të jetë e pastër nga *Liriomyza huidobrensis* (Blanchard) and *Liriomyza*

rhizomat,
farërat,

tuberët,

me origjinë nga vendet e treta (joanëtare të BE-së). trifolii (Burgess); ose

(b) gjithashtu asnjë shenjë e *Liriomyza huidobrensis* (Blanchard) dhe *Liriomyza trifolii* (Burgess) nuk është vërejtur në vendin e prodhimit, bazuar mbi inspektimet zyrtare të kryera të paktën çdo muaj gjatë tre muajve të fundit para vjeljes; ose

(c) menjëherë para eksportimit, bimët janë inspektuar zyrtarisht dhe janë gjetur të pastra nga *Liriomyza huidobrensis* (Blanchard) dhe *Liriomyza trifolii* (Burgess) dhe kanë qenë subjekt i trajtimit përkatës kundër *Liriomyza huidobrensis* (Blanchard) dhe *Liriomyza trifolii* (Burgess)

33. Bimë me rrënjë, të mbjella ose të planifikuara për mbjellje, të rritura në fushë të hapur. Deklarimi zyrtar që vendi i prodhimit është njohur të jetë i pastër nga *Clavibacter michiganensis* ssp. *sependoniscus* (Spieckermann and Kotthoff) Davis et al., *Globodera pallida* (Stone) Behrens, *Globodera rostochiensis* (Wollenweber) Behrens dhe *Synchytrium endobioticum* (Schilbersky) Percival.

34. Tokë ose terren rritës bashkëngjitur ose të shoqëruar me bimët, të përbërë tërësisht ose pjesërisht prej toke ose substancave organike të ngurta të tilla si pjesë bimësh, humus, përfshirë torfën ose lëkurë ose çdo substancë inorganike të ngurtë, që shërben për të mbështetur vitalitetin e bimëve, me origjinë nga: Turqia, Bjellorusia, Gjeorgjia, Moldavia, Rusia, Ukraina,

Vendet joeuropiane të ndryshme nga Algjeria, Egjipti, Izraeli, Libia, Moroku, Tunizia.

Deklarimi zyrtar që:

(a) terreni rritës, në kohën e mbjelljes, ishte: i pastër nga toka dhe lënde organike; ose gjetur i pastër nga insektet dhe nematodet parazitare dhe subjekt i ekzaminimit përkatës ose trajtimit me nxehtësi, ose fumigimit, për të garantuar pastërtinë nga parazitët; ose subjekt i trajtimit të përshtatshëm me nxehtësi ose fumigimit për të garantuar pastërtinë nga parazitët; dhe

(b) që nga mbjellja:

janë marrë masat e nevojshme për të siguruar që terreni rritës është mbajtur i pastër nga parazitët; ose

brenda dy javësh para shpërndajjes, bimët ishin shkundur për të qenë të pastra nga terreni duke lënë sasi minimale të nevojshme për të ruajtur vitalitetin gjatë transportit, dhe terreni ushqyes i përdorur për atë qëllim plotëson kërkesat e përshkruara në (a).

35.1. Bimët e *Beta vulgaris* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat. Deklarimi zyrtar që asnjë simptomë e Beet curly top virus (izolate joeuropiane) nuk është vërejtur në vendin e prodhimit që nga fillimi i ciklit të fundit të plotë vegjetativ.

35.2. Bimët e *Beta vulgaris* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku Beet leaf curly top virus dihet se është hasur. Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët, të listuara në aneksin IV(A)(I)(35.1), deklarimi zyrtar që:

(a) beet leaf curl virus nuk është njohur të jetë hasur në zonën e prodhimit; dhe

(b) asnjë simptomë e beet leaf curl virus nuk është vërejtur në vendin e prodhimit, ose në afërsi imediate me të, që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegjetativ.

36.1. Bimët, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme

nga:

bulbat,

drithi,

rhizomat,

farërat,

tuberët,

me origjinë nga vendet e treta (joanëtare të BE-së). Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët në aneksin IV, pjesa A, seksioni I(27.1), (27.2), (28), (29), (31), (32.1) dhe (32.3), deklarimi zyrtar që bimët janë rritur në fidanishte dhe:

(a) janë me origjinë nga një zonë, e përcaktuar nga shërbimi nacional i mbrojtjes së bimëve në vendin eksportues, që është e pastër nga Thrips palmi Karny në pajtim me standardet ndërkombëtare përkatëse për masat fitosanitare, dhe kjo është përmendur në certifikatat e referuara në artikujt 7 ose 8 të kësaj direktive, në rubrikën "Deklarime shtesë"; ose

(b) janë me origjinë nga një vend prodhimi, i përcaktuar nga shërbimi nacional i mbrojtjes së bimëve në vendin eksportues, që është i pastër nga Thrips palmi Karny në pajtim me standardet ndërkombëtare përkatëse për masat fitosanitare, dhe kjo është përmendur në certifikatat e referuara në Artikujt 7 ose 8 të kësaj Direktive, në rubrikën "Deklarime shtesë", dhe janë deklaruar të pastra nga Thrips palmi Karny nga inspektimet zyrtare të kryera së paku çdo muaj gjatë tre muajve të fundit para eksportimit; ose

(c) menjëherë para eksportimit, kanë qenë subjekt i një trajtimi përkatës kundër Thrips palmi Karny dhe janë

inspektuar zyrtarisht e janë gjetur të pastra nga Thrips palmi Karny. Detaje mbi trajtimin duhet të jenë përmendur në certifikatat e referuara në Artikujt 7 ose 8 të kësaj Direktive.

36.2. Lulet e prera të Orchidaceae dhe fruta të Momordica L. dhe Solanum melongena L., me origjinë nga vendet e treta (joanëtare të BE-së). Deklarimi zyrtar që lulet e prera dhe frutat: janë me origjinë nga një vend i pastër nga Thrips palmi

Karny; ose

menjëherë para eksportimit janë inspektuar zyrtarisht dhe janë gjetur të pastra nga Thrips palmi Karny.

37. Bimët e Palmae të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vendet joeuropiane. Pa cenuar ndalesat e aplikueshme për bimët e listuara përkatësisht në aneksin III(A)(17), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët janë me origjinë nga një zonë e njohur të jetë e pastër nga Palm lethal yellowing mycoplasma dhe Cadang- Cadang viroid, asnjë simptomë e tyre nuk është vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate me të që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ; ose

(b) asnjë prej simptomave të Palm lethal yellowing mycoplasma dhe Cadang-Cadang viroid nuk janë vërejtur mbi bimë që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegjetativ, dhe bimët në vendin e prodhimit që kanë shfaqur simptoma duke ngritur dyshimin e kontaminimit nga

organizmat e mësipërm janë asgjësuar në atë vend dhe bimët i janë nënshtruar trajtimit përkatës për pastrimin e tyre nga *Myndus crudus* Van Duzee;

(c) në rastin e bimëve in vitro, bimët kanë rrjedhur nga bimë që kanë plotësuar kërkesat e përshkruara në (a) ose (b).

38.1. Bimët e *Camellia* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende joeuropiane. Deklarimi zyrtar që:

(a) bimët janë me origjinë nga zona të njohura të jenë të pastra nga *Ciborinia camelliae* Kohn; ose

(b) asnjë simptomë e *Ciborinia camelliae* Kohn nuk është vërejtur mbi bimët në lulëzim që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegjetativ.

38.2. Bimët e *Fuchsia* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga SHBA-ja ose Brazili. Deklarimi zyrtar që asnjë simptomë e *Aculops fucsiae* Keifer nuk është vërejtur në vendin e prodhimit dhe që menjëherë para eksportimit bimët janë inspektuar dhe janë gjetur të pastra nga *Aculops fucsiae* Keifer.

39. Pemët dhe shkurret, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat dhe bimët in vitro, me origjinë nga vendet e treta (joanëtare të BE-së), të ndryshme nga vendet europiane dhe mesdhetare. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët të listuara përkatësisht në aneksin III(a)(1), (2), (3), (9), (13), (15), (16),

(17), (18), aneksin III(B)(1) dhe aneksin IV(A)(I)(8.1), (8.2), (9), (10), (11.1), (11.2), (12), (13.1), (13.2), (14), (15), (17),

(18), (19.1), (19.2), (20), (22.1), (22.2), (23.1), (23.2), (24), (25.5), (25.6), (26), (27.1),

(27.2), (28), (29), (32.1), (32.2), (33), (34), (36.1), (36.2), (37), (38.1) dhe (38.2), deklarimi zyrtar që bimët:

janë të pastra (d.m.th., të pastra nga copëra mbeturina bimore) dhe të pastra nga lulet dhe frutat, janë rritur në fidanishte,

janë inspektuar në kohë të caktuara dhe para eksportimit dhe janë gjetur të pastra nga simptoma të parazitëve bakterialë, viruseve dhe organizmave si-viruset dhe gjithashtu janë gjetur të pastra nga shenja ose simptoma të nematodeve, insekteve, këpushave dhe kërpudhave parazitare, ose kanë qenë subjekt i trajtimeve përkatëse për eliminimin e organizmave të tillë.

40. Pemët dhe shkurret gjetherënëse, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat dhe bimët in vitro, me origjinë nga vendet e treta (joanëtare të BE-së), të ndryshme nga vendet europiane dhe mesdhetare. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët të listuara përkatësisht në aneksin III(A)(2), (3), (9), (15), (16), (17) dhe (18), aneksin III(B)(1) dhe aneksin IV(A)(I), (11.1), (11.2), (11.3), (12), (13.1), (13.2), (14), (15), (17), (18), (19.1), (19.2), (20), (22.1), (22.2), (23.1), (23.2), (24), (33), (36.1), (38.1), (38.2), (39) dhe (45.1) deklarimi zyrtar që bimët janë të fjetura (në gjendje qetësie) dhe janë pa gjethe.

41. Bimët një- dhe dyvjeçare, të ndryshme nga Gramineae, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat me origjinë nga vende ndryshe nga ato europiane dhe mesdhetare. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët, përkatësisht të listuara në aneksin III(A)(11), (13) dhe aneksin IV(A)(I)(25.5), (25.6), (32.1), (32.2), (32.3), (33), (34), (35.1) dhe (35.2),

deklarimi zyrtar që bimët:

janë rritur në fidanishte,

janë pa copëra mbeturina bimore, lule dhe fruta, janë inspektuar në kohë të caktuara dhe para eksportimit, dhe janë gjetur të pastra nga simptoma të parazitëve bakterialë, viruseve dhe organizmave si-viruset dhe

gjithashtu janë gjetur të pastra nga shenja ose simptoma të nematodeve, insekteve, këpushave dhe kërpudhave parazitare, ose kanë qenë subjekt i trajtimeve përkatëse për eliminimin e organizmave të tillë.

42. Bimët e familjes Gramineae barëra shumëvjeçare zbukurues të nënfamiljeve Bambusoideae, Panicoideae dhe të gjinive Buchloe, Bouteloua Lag., Calamagrostis, Cortaderia Stapf., Glyceria R. Br., Hakonechloa Mak. ex Honda, Hystrix, Molinia, Phalaris L., Shibataea, Spartina

Schreb., Stipa L. dhe Uniola L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat me origjinë nga vende ndryshe nga ato europiane dhe mesdhetare. Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët, përkatësisht të listuara në aneksin IV(A)(I)(33) dhe (34), deklarimi zyrtar që bimët:

janë rritur në fidanishte, dhe janë të pastra nga copëra mbeturina bimore, lule dhe fruta, dhe janë inspektuar në kohë të caktuara dhe para eksportimit, dhe janë gjetur të pastra nga simptoma të parazitëve bakterialë, viruseve dhe organizmave si-viruset, dhe gjithashtu, janë gjetur të pastra nga shenja ose simptoma të nematodeve, insekteve, këpushave dhe kërpudhave parazitare, ose kanë qenë subjekt i trajtimeve përkatëse për eliminimin e organizmave të tillë.

43. Bimë të xhuxhëzuara në mënyrë natyrore ose artificiale të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende joeuropiane. Pa cenuar kushtet e aplikueshme për bimët të listuara përkatësisht në aneksin III(A)(1), (2), (3), (9), (13), (15), (16), (17), (18), aneksin III(B)(1) dhe aneksin IV(A)(I)(8.1), (9), (10), (11.1), (11.2), (12), (13.1), (13.2), (14), (15), (17), (18), (19.1), (19.2), (20), (22.1), (22.2), (23.1), (23.2), (24), (25.5), (25.6), (26), (27.1), (27.2), (28), (32.1), (32.2), (33), (34), (36.1), (36.2), (37), (38.1), (38.2), (39), (40) dhe (42), deklarimi zyrtar që:

(a) bimët, përfshirë ato të mbledhura direkt nga vendjetesa natyrore, duhet të kenë qenë rritur, mbajtur dhe kalitur për të paktën dy vite të njëpasnjëshëm përpara shpërndarjes në fidanishte të regjistruara zyrtarisht, të cilat janë subjekt i një regjimi kontrolli mbikëqyrës zyrtar;

(b) bimët në fidanishte të referuara në (a) duhet të: (aa) të paktën gjatë periudhës së referuar në (a):

të jenë vendosur në vazo, të cilat janë vendosur në tezga të ngritura së paku 50 cm mbi tokë, kanë qenë subjekt i trajtimeve përkatëse për të garantuar pastërtinë nga racat joeuropiane të ndryshqeve: lënda vepruese, përqendrimi dhe data e trajtimeve duhet të jetë përmendur në certifikatën fitosanitare sipas artikullit 7 të kësaj direktive në rubrikën "Dezinfektim dhe/ose dezinfektim". janë inspektuar zyrtarisht të paktën gjashtë herë në vit në intervale kohe të

caktuara, për praninë e parazitëve që lidhen me to, që përmenden në anekset e kësaj direktive. Këto inspektime që, gjithashtu, duhet të jenë kryer mbi bimët në afërsi imediate me fidanishtet e referuara në (a), duhet të jenë kryer të paktën me anë të ekzaminimit vizual në çdo rresht në fushë ose fidanishte dhe me anë të ekzaminimit vizual mbi të gjitha pjesët e bimëve mbi terrenin rritës, duke përdorur një kampion të rastit prej së paku 300 bimë për gjini, ku numri i bimëve për atë gjini nuk është më tepër se 3000, ose 10% të bimëve nëse janë më shumë se 3000 bimë prej asaj gjinie, në këto inspektime janë gjetur të pastra nga parazitët përkatës të specifikuara në kryeradhën e mësipërme. Bimët e infektuara duhet të jenë larguar. Bimët e mbetura përkatësisht duhet të jenë trajtuar efektivisht, dhe përveç kësaj duhet të jenë mbajtur për një periudhë kohe të caktuar dhe të jenë inspektuar për të siguruar pastërtinë prej parazitëve që lidhen me ato, janë mbjellë në terrene rritës artificialë të pa përdorur, ose në një terren rritës natyral që ka qenë trajtuar me fumigim ose

me trajtim të përshtatshëm me nxehtësi dhe ka qenë pa parazitë, ka qenë mbajtur në kondita të cilat sigurojnë që terreni rritës është mbajtur i pastër nga parazitët dhe brenda dy javëve përpara shpërndarjes kanë qenë: shkundur dhe larë me ujë të pastër për të larguar terrenin rritës origjinal dhe për të nxjerrë në dukje rrënjëzimin, ose shkundur dhe larë me ujë të pastër për të larguar terrenin rritës origjinal dhe rimbjellë në terren rritës tjetër që plotëson kushtet e përshkruara në (aa) kryeradha e pestë, ose kanë qenë subjekt i trajtimeve përkatëse për të siguruar që terreni rritës është i pastër nga parazitët, lënda vepruese, përqendrimi dhe data e kryerjes së këtyre trajtimeve duhet të jetë përmendur në certifikatën fitosanitare sipas artikullit 7 të kësaj Direktive në rubrikën "Dezinfektim dhe /ose dezinfektim".

(bb) të jenë paketuara në kontejnerë të mbyllur të cilët janë vulosur zyrtarisht ku del në pah numri i regjistrimit të fidanishtes së regjistruar, ky numër, gjithashtu, duhet të tregohet në rubrikën deklarime shtesë të certifikatës fitosanitare sipas artikullit 7 të kësaj direktive, duke mundësuar identifikimin e ngarkesës.

44. Bimët barishtore shumëvjeçare të familjeve Caryophyllaceae (përveç *Dianthus* L.), Compositae (përveç *Dendranthema* (DC.) Des Moul.), Cruciferae, Leguminosae dhe Rosaceae (përveç *Fragaria* L.), të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat me origjinë nga vendet e treta (joanëtare të BE-së), të ndryshme nga vendet europiane dhe mesdhetare. Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët e listuara përkatësisht në aneksin IV(A)(I)(32.1), (32.2), (32.3), (33) dhe (34), deklarimi zyrtar që bimët: janë rritur në fidanishte; dhe janë të pastra nga copëra mbeturinash bimore, lule dhe fruta; dhe janë inspektuar në kohë të caktuara dhe para eksportimit, dhe janë gjetur të pastra nga simptoma të parazitëve bakterialë, viruseve dhe organizmave si-viruset dhe gjithashtu janë gjetur të pastra nga shenja ose simptoma të nematodeve, insekteve, këpushave dhe kërpudhave parazitare, ose kanë qenë subjekt i trajtimeve përkatëse për eliminimin e organizmave të tillë.

45.1. Specie të bimëve barishtore dhe bimët e *Ficus* L. dhe *Hibiscus* L., të planifikuara për

mbjellje, të ndryshme nga bulbat, drithi, rizomat, farat dhe tuberët me origjinë nga vende joeuropiane. Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët në aneksin IV, pjesa A, seksioni I(27.1), (27.2), (28), (29), (32.1), (32.3) dhe (36.1), deklarimi zyrtar që bimët:

(a) janë me origjinë nga një zonë e përcaktuar nga shërbimi nacional i mbrojtjes së bimëve në vendin eksportues, që është e pastër nga Bemisia tabaci Genn. (populacione joeuropiane) në pajtim me standardet ndërkombëtare përkatëse për masat fitosanitare, dhe kjo është përmendur në certifikatat e referuara në artikujt 7 ose 8 të kësaj direktive, në rubrikën "Deklarime shtesë"; ose

(b) janë me origjinë nga një vend prodhimi, i përcaktuar nga shërbimi nacional i mbrojtjes së bimëve në vendin eksportues, që është i pastër nga Bemisia tabaci Genn. (populacione joeuropiane) në pajtim me standardet ndërkombëtare përkatëse për masat fitosanitare, dhe kjo është përmendur në certifikatat e referuara në artikujt 7 ose 8 të kësaj direktive, në rubrikën "Deklarime shtesë", dhe janë deklaruar të pastra nga Bemisia tabaci Genn. (populacionet joeuropiane) nga inspektimet zyrtare të kryera së paku një herë në çdo tri javë gjatë nëntë javëve të fundit para eksportimit; ose

(c) në rastet ku Bemisia tabaci Genn. (populacionet joeuropiane) janë gjetur në vendin e prodhimit, janë mbajtur ose prodhuar në këtë vend prodhimi dhe i janë nënshtruar një trajtimi përkatës për të siguruar pastërtinë nga Bemisia tabaci Genn. (populacione joeuropiane) dhe më vonë ky vend prodhimi është gjetur i pastër nga Bemisia tabaci Genn. (populacionet joeuropiane) si pasojë e implementimit të procedurave përkatëse duke synuar çrrënjosjen e Bemisia

tabaci Genn. (populacioneve joeuropiane), në inspektimet zyrtare të kryera çdo javë gjatë nëntë javëve të fundit para eksportimit ashtu dhe në procedurat e monitorimit gjatë periudhës së përmendur më sipër. Detaje mbi trajtimet duhet të përmendur në certifikatat e referuara në artikullin 7 ose 8 të kësaj direktive.

45.2. lulet e prera të Aster spp., Eryngium L., Gypsophila L., Hypericum L., Lisianthus L., Rosa L., Solidago L., Trachelium L., dhe perimet gjethore të Ocimum L., me origjinë nga vende joeuropiane. Deklarimi zyrtar që lulet e prera dhe perimet gjethore: janë me origjinë nga një vend i pastër nga Bemisia tabaci Genn. (populacione joeuropiane); ose menjëherë para eksportimit, janë inspektuar zyrtarisht dhe janë gjetur të pastra nga Bemisia tabaci Genn. (populacionet joeuropiane).

45.3. Bimët e Lycopersicon lycopersicum (L.) Karsten ex Farw. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, me origjinë nga vende ku Tomato yellow leaf curl virus dihet të jetë hasur. Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët e listuara përkatësisht në aneksin III(A)(13) dhe aneksin (A)(I)(25.5), (25.6) dhe 25.7.

Ku Bemisia tabaci Genn. nuk dihet të jetë hasur. Deklarimi zyrtar që asnjë simptomë e Tomato yellow leaf curl virus nuk është vërejtur mbi bimët.

(b) Ku Bemisia tabaci Genn. dihet të jetë hasur. Deklarimi zyrtar që:

(a) asnjë simptomë e Tomato yellow leaf curl virus nuk është vërejtur mbi bimë; dhe

(aa) bimët janë me origjinë nga zona të njohura të jenë të pastra nga Bemisia tabaci Genn.;

ose

(bb) vendi i prodhimit është gjetur i pastër nga *Bemisia tabaci* Genn. Nga inspektimet zyrtare të kryera të paktën çdo muaj gjatë tre muajve të fundit para eksportimit; ose

(b) asnjë simptomë e Tomato yellow leaf curl virus nuk është vërejtur në vendin e prodhimit dhe vendi i prodhimit ka qenë subjekt i një trajtimi të veçantë dhe nën regjim monitorimi për të siguruar pastërtinë nga *Bemisia tabaci* Genn.

46. Bimët e planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat, bulbat, tuberët, drithi dhe rizomat me origjinë nga vende ku parazitët përkatës janë njohur të jenë hasur

Parazitët përkatës janë:

Bean golden mosaic virus,

Cowpea mild mottle virus,

Lettuce infectious yellow virus,

Pepper mild tigre virus,

Squash leaf curl virus,

Viruse të tjera të transmetuara nga *Bemisia tabaci* Genn Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët e listuara përkatësisht në aneksin III(A)(13) dhe aneksin IV(A)(I)(25.5) (25.6), (32.1), (32.2), (32.3), (35.1), (35.2), (44), (45), (45.1), (45.2) dhe (45.3) where appropriate.

(a) Ku *Bemisia tabaci* Genn. (populacionet joeuropiane) ose vektorët e tjerë të parazitëve përkatës nuk janë njohur të jenë hasur. Deklarimi zyrtar që asnjë simptomë e parazitëve përkatës nuk është vërejtur mbi bimët gjatë ciklit të plotë të tyre vegetativ.

(b) Ku *Bemisia tabaci* Genn. (populacionet joeuropiane) ose vektorët e tjerë të parazitëve përkatës janë njohur të jenë hasur. Deklarimi zyrtar që asnjë simptomë e parazitëve përkatës nuk është vërejtur mbi bimët gjatë një periudhe të mjaftueshme; dhe

(a) bimët janë me origjinë nga zona të njohura të jenë të pastra nga *Bemisia tabaci* Genn. dhe vektorë të tjerë të parazitëve përkatës; ose

(b) vendi i prodhimit është gjetur i pastër nga *Bemisia tabaci* Genn. dhe vektorët e tjerë të parazitëve përkatës nga inspektimet zyrtare të kryera në kohë të përshtatshme; ose

(c) bimët kanë qenë subjekt i trajtimit të veçantë me qëllim çrrënjësjes së *Bemisia tabaci* Genn.

47. Farat e *Helianthus annuus* L. Deklarimi zyrtar që:

(a) farat janë me origjinë nga një zonë e njohur të jetë e pastër nga *Plasmopara halstedii* (Farlow) Berl. and de Toni; ose

(b) farat, të ndryshme nga ato që janë prodhuar nga varietete rezistente ndaj të gjitha racave të *Plasmopara halstedii* (Farlow) Berl. and de Toni prezente në zonën e prodhimit, kanë qenë subjekt i një trajtimi të veçantë kundër *Plasmopara halstedii* (Farlow) Berl. and de Toni.

48. Farat e *Lycopersicon lycopersicum* (L.) Karsten ex Farw. Deklarimi zyrtar që farat janë përfituar me anë të një metode përkatëse ekstraktimi me acid ose një metode ekuivalente të miratuar në pajtim me procedurën e përkthyer në artikullin 18(2); dhe

(a) farat janë me origjinë nga zona ku *Clavibacter michiganensis* ssp. *michiganensis* (Smith)

Davis et al., *Xanthomonas campestris* pv. *vesicatoria* (Doidge) Dye dhe Potato spindle tuber viroid janë njohur të jenë hasur, ose

(b) asnjë simptomë e sëmundjeve të shkaktuara nga këta parazitë nuk është vërejtur mbi bimë në vendin e prodhimit gjatë ciklit të tyre të plotë vegetativ; ose

(c) farat kanë qenë subjekt i testimit zyrtar të një mostre përfaqësuese, duke përdorur metoda përkatëse, të paktën për këta parazitë dhe nga këto testime janë gjetur të pastra nga këta parazitë.

49.1 Farat e *Medicago sativa* L. Deklarimi zyrtar që:

(a) asnjë simptomë e *Ditylenchus dipsaci* (Kuhn) Filipjev nuk është vërejtur në vendin e prodhimit që prej fillimit të ciklit të fundit të plotë vegetativ dhe asnjë *Ditylenchus dipsaci* (Kuhn) Filipjev nuk është gjetur me anë të testeve laboratorike mbi një mostër përfaqësuese; ose

(b) është kryer fumigimi para eksportimit.

49.2. Farat e *Medicago sativa* L., me origjinë nga vende ku *Clavibacter michiganensis* ssp. *insidiosus* Davis et al. është njohur të jetë hasur. Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin IV(A)(I)(49.1), deklarimi zyrtar që:

(a) *Clavibacter michiganensis* ssp. *insidiosus* Davis et al. nuk është njohur të jetë hasur në fermë ose në afërsi imediate me të që prej fillimit të 10 vitëve të shkuara;

(b) gjithashtu

kultura i përket një varietetit të pranuar si mjaft rezistent ndaj *Clavibacter michiganensis* ssp. *insidiosus* Davis et al., ose kultura nuk kishte filluar akoma ciklin e katërt të plotë të vegetacionit nga mbjellja, kur u mblodh fara, dhe nuk ka pasur më shumë se një nxjerrje të mëparshme fare nga kultura; ose

përmbajtja e lëndës inerte nuk i kalon 0,1% (në peshë) e përcaktuar kjo në përputhje me rregullat e aplikueshme për certifikimin e farës që tregtohet në Komunitetin Europian;

(c) asnjë simptomë e *Clavibacter michiganensis* ssp. *insidiosus* Davis et al. nuk është vërejtur në vendin e prodhimit, ose nuk është vërejtur në vendin e prodhimit ose mbi çdo ngastër me *Medicago sativa* L, fqinjë me të, gjatë gjithë ciklit të fundit të plotë vegetativ ose, përkatësisht, gjatë dy cikleve të fundit vegetativë;

(d) kultura është rritur në një ngastër, ku gjatë 3 viteve paraardhëse nuk ka qenë prezent asnjë kulturë *Medicago sativa* L.

50. Farat e *Oryza sativa* L. Deklarimi zyrtar që:

(a) farat janë testuar zyrtarisht me anë të testeve nematologjike dhe janë gjetur të pastra nga *Aphelenchoides besseyi* Christie; ose

(b) farat kanë qenë subjekt i trajtimit përkatës me ujë të ngrohtë ose trajtimeve të tjera të përkatëse kundër *Aphelenchoides besseyi* Christie.

51. Farat e *Phaseolus* L. Deklarimi zyrtar që:

(a) farat janë me origjinë nga zona të njohura të jenë të pastra nga *Xanthomonas campestris* pv. *phaseoli* (Smith) Dye; ose

(b) një mostër përfaqësuese e farave është testuar dhe është gjetur e pastër nga *Xanthomonas campestris* pv. *phaseoli* (Smith) Dye në këto testime.

52. Farat e Zea mais L. Deklarimi zyrtar që:

(a) farat janë me origjinë nga zona të njohura të jetë të pastra nga *Erwinia stewartii* (Smith) Dye; ose

(b) një mostër përfaqësuese e farave është testuar dhe është

gjetur e pastër nga *Erwinia stewartii* (Smith) Dye në këtë testim.

53. Farat e bimëve të gjinive *Triticum*, *Secale* dhe X *Triticosecale* nga Afganistani, India, Irani, Iraku, Meksika, Nepali, Pakistani, Afrika e Jugut dhe SHBA-ja ku *Tilletia indica* Mitra është njohur të jetë hasur. Deklarimi zyrtar që farat janë me origjinë nga një zonë ku *Tilletia indica* Mitra është njohur të jetë hasur. Emri i zonës duhet të jetë përmendur në certifikatën fitosanitare parashikuar në artikullin 7.

54. Kokrrat e drithit nga bimë të gjinive *Triticum*, *Secale* dhe X *Triticosecale* nga Afganistani, India, Irani, Iraku, Meksika, Nepali, Pakistani, Afrika e Jugut dhe SHBA-ja ku *Tilletia indica* Mitra është njohur të jetë hasur. Deklarimi zyrtar që,

(i) drithi është me origjinë nga një zonë ku *Tilletia indica* Mitra nuk është njohur të jetë hasur. Emri i zonës ose zonave duhet të jetë përmendur në certifikatën fitosanitare parashikuar në artikullin 7, në rubrikën "Vendi i origjinës"; ose

(ii) asnjë simptomë e *Tilletia indica* Mitra nuk është vërejtur mbi bimët në vendin e prodhimit gjatë ciklit të tyre të plotë vegjetativ dhe mostra përfaqësuese të kokrave të drithit të mara në kohën e korrjes po ashtu edhe para transportimit ka qenë testuar dhe është gjetur e pastër nga *Tilletia indica* Mitra në këto teste; kjo duhet të jetë përmendur në certifikatën fitosanitare parashikuar në artikullin 7, në rubrikën "emri i produktit" po ashtu "testuar dhe gjetur i pastër nga *Tilletia indica* Mitra".

SEKSIONI II

BIMË, PRODUKTE BIMORE DHE OBJEKTE TË TJERA ME ORIGJINË NË SHQIPËRI

Bimët, produktet bimore dhe objekte të tjera Kërkesa të veçanta

2. Druri i *Platanus* L., përfshirë dru që nuk ka ruajtur sipërfaqen e rrumbullakët natyrore të tij. (a) Deklarimi zyrtar që druri është me origjinë nga zona të njohura të jenë të pastra nga *Ceratocystis fimbriata* f.sp. *platani* Walter; ose

(b) duhet të jetë evidente me anë të një vule "Kiln-dried", "KD" ose të një stampe tjetër të pranuar në nivel ndërkombëtar, e vendosur mbi dru ose mbi paketimin e tij në pajtim me përdorimin tregtar të kohës, që druri i është nënshtruar një procesi kiln-drying (tharje me furrë) deri në 20% përmbajtje lagështie, e shprehur kjo si një përqindje ndaj lëndës së thatë, në kohën e fabrikimit, e arritur përmes zbatimit të një skede përkatëse kohë/temperature.

4. Bimët e *Pinus* L. të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat. Deklarimi zyrtar që asnjë simptomë e *Scirrhia pini* Funk and Parker nuk është vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate me të që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegjetativ.

5. Bimët e *Abies* Mill., *Larix* Mill., *Picea* A. Dietr., *Pinus* L., *Pseudotsuga* Carr. Dhe *Tsuga*

Carr., të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat. Pa cenuar kërkesat e aplikueshme për bimët e listuara në aneksin IV(A)(II)(4), përkatësisht, deklarimi zyrtar që asnjë simptomë e *Melampsora medusae* Thumen nuk është vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate me të që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegetativ.

6. Bimët e *Populus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat Deklarimi zyrtar që asnjë simptomë e *Melamp sora medusae* Thumen nuk është vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate me të që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegetativ.

7. Bimët e *Castanea Mill.* dhe *Quercus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat. Deklarimi zyrtar që:

(a) bimët janë me origjinë nga zona të njohura të jenë të pastra nga *Cryphonectria parasitica* (Murrill) Barr

ose

(b) asnjë simptomë e *Cryphonectria parasitica* (Murrill) Barr nuk është vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate me të që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegetativ.

8. Bimët e *Platanus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat. Deklarimi zyrtar që:

(a) bimët janë me origjinë nga një zonë e njohur të jetë e pastër *Ceratocystis fimbriata f.sp.* platani Walter; ose

(b) asnjë simptomë e *Ceratocystis fimbriata f.sp.* platani Walter, nuk është vërejtur në vendin e prodhimit ose në afërsi imediate me të që prej fillimit të ciklit të fundit, të plotë vegetativ.

9. Bimët e *Amelanchier Med.*, *Chaenomeles Lindl.*, *Cotoneaster Ehrh.*, *Crataegus L.*, *Cydonia Mill.*, *Eriobotrya Lindl.*, *Malus Mill.*, *Mespilus L.*, *Photinia davidiana (Dcne.) Cardot*, *Pyracantha Roem.*, *Pyrus L.* and *Sorbus L.*, të planifikuara për mbjellje, të ndryshme nga farat. Deklarimi zyrtar:

(a) bimët janë me origjinë nga zona të pranuar të jenë të pastra nga *Erwinia amylovora* (Burr.) Winsl. et al; ose

(b) që bimët në fushën e prodhimit dhe në afërsi imediate me të, që kanë shfaqur simptoma të *Erwinia amylovora* (Burr.) Winsl. et al., janë asgjësuar.

10. Bimët e *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, të ndryshme nga frutat dhe farat. Deklarimi zyrtar që:

(a) bimët janë me origjinë nga zona të njohura të jenë të pastra nga *Spiroplasma citri* Saglio et al., *Phoma tracheiphila* (Petri), *Kanchaveli and Gikashvili*, *Citrus vein enation woody gall* dhe *Citrus tristeza virus* (shtame europiane); ose

(b) bimët rrjedhin nga një skemë certifikimi duke kërkuar që ato të kenë rrjedhur në vijë të drejtë nga materiali, i cili është mbajtur në kushte të caktuara dhe ka qenë subjekt i testimi zyrtar individual së paku për *Citrus tristeza virus* (shtamet europiane) dhe *Citrus vein enation woody gall*, duke përdorur indikatorët përkatës ose metoda ekuivalente, të miratuara në

pajtim me procedurën e përshkruar në artikullin 18(2), dhe janë rritur në mënyrë të përhershme në një serë të mbrojtur nga insektet, ose në një kafaz të izoluar, mbi të cilat asnjë simptomë e *Spiroplasma citri* Saglio et al., *Phoma tracheiphila* (Pandri) *Kanchaveli and*

Gikashvili, Citrus tristeza virus (shtamet europiane) dhe Citrus vein enation woody gall nuk është vërejtur; ose (c) bimët:

